

«Gazetat lokale të Amerikës,
të mëdha apo vogla, regjistrojnë
kronikat e jetës së përditshme të vendit tonë,
të popullit tonë... Po t'i mbledhësh të gjitha
së bashku, gazetatat e bashkësive
tregojnë jo thjesht historinë e lirisë
amerikane, por histori janë ato vetë.»

*Kolin Pauell, Sekretar i Shtetit i SHBA
Fjalim përpara Shoqatës Amerikane të Gazetave, 25 Mars 2001*

Përmbajtja

Media dhe Etika

FOKUS

- Përcaktimi i Hapësirës së Pushtetit të Katërt** 6
Amendamenti i Parë, ekonomia dhe presupozimi kundër sistemit rregullator luajnë role madhore në realizimin e lirisë së shtypit në Shtetet e Bashkuara.
Nga Nikolas Xhonsen, Profesor i Jashtëm i Drejtësisë, Kolegji i Drejtësisë i Universitetit të Ajuës.

GAZETARIA E SOTME NË SHTETET E BASHKUARA

- Roli i Medias në Ndërtimin e Bashkësisë** 10
Një lloj i ri gazetarie i sfidon qytetarët të aktivizohen dhe të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve në bashkësitë e tyre.
Nga Jan Shefër, Drejtor Ekzekutiv, Qendra Pju për Gazetarinë Qytetare (Pew Center for Civic Journalism)
- Pse i Nevojitet Demokracisë Gazetaria Investiguese** 15
Pasqyrimi hulumtues vazhdon të jetë një prej kontributeve më të rëndësishme që shtypi i bën demokracisë, por gazetarët e kësaj fushe duhet të vlerësojnë vazhdimisht etikën e teknikave të tyre.
Nga Silvio Ueishbord, Autor i «Gazetaria Vigjëluese në Amerikën e Jugut: Lajmet, Përgjegjshmëria dhe Demokracia.»
- Udhëtim Njëpër «Fushën e Minuar të Etikës»** 19
Një reporter investigues përballet me një dilemë etike në publikimin e një lajmi për fëmijët e prindërve të dhënë pas drogës.
Nga Tran Ha, reporter në Institutin Pointer (Poynter Institute)
- Ç'Janë Qentë Roje të Medias** 21
Grupet vigjëluese të medias karakterizohen nga motivime dhe anshmëri vetjake, të cilat duhen vlerësuar për të kuptuar kritikën e tyre.
Nga Virxhinia Uajthauz, Asistente Professore e Studimeve të Komunikimit, Kolegji Uituërth, Spokejn, Uashington
- Gazetaria në Epokën e Internetit** 26
Shpejtësia dhe ndërveprueshmëria, një tipar tërheqës i gazetarisë së Internetit, mund të jenë edhe faktorë që minojnë praktikën tradicionale të saktësisë, paanshmërisë e qartësisë.
Nga Bob Gails, Botues i Raporteve Nieman, Fondacioni Nieman i Gazetarisë (Nieman Foundation of Journalism), Universiteti Harvard

Lajmet në Epokën e Parasë 28

Gazetarët ekonomikë që pasqyrojnë një ekonomi me zhvillim të vullshëm përballen me dilema etike për shkak të tundimit për t'i shtrembëruar pasqyrimet e tyre për të përfituar prej tregjeve në rritje.

Nga Diana B. Henrikes, Reportere Financiare në The New York Times

Kodet e Etikës së Medias dhe Përtej Tyre 31

Dy eticienë të shquar analizojnë kodet e etikës së ndjekur prej gazetarëve në 33 gazeta të SHBA duke shqyrtuar çdo gjë, prej mënyrës së trajtimit të dilemave morale, deri tek trajtimi i ndikimeve të teknologjive të reja.

Nga Robert Stil dhe Xhei Blek

BURIME SHITESË

Bibliografi 36

Libra, dokumente dhe artikuj mbi çështje të gazetarisë.

Burime të Përzgjedhura në Internet 38

Një listë me sajte Interneti që ofrojnë informacion të mëtejshëm mbi organizatat e medias dhe grupet e gazetarëve.

Çështje Globale

Revistë Elektronike e Departamentit të Shtetit të SHBA

ejglobal@pd.state.gov

Botues	Judith S. Siegel
Redaktor	William Peters
Redaktor Përgjegjës	Jim Fuller
Redaktor Teksti	Charlene Porter
Redaktor Interneti	Tim Brown
Asistentë Redaktorë	Carlos Aranaga
.....	Jenifer Bochner
.....	Melissa Cooper
.....	Wayne Hall
.....	Kathleen Hug
.....	Cynthia LaCovey
.....	Paul Malamud
.....	Ellen Toomey
.....	Rosalie Targonski
Referencat dhe Kërkimet	Joan Taylor
Drejtor Artistik	Chloe Ellis
Asistente Grafiste	Sylvia Scott

Editor, Global Issues & Communications
Office of International Information Programs
IIP/T/GIC
U.S. Department of State
301 4th Street, S.W.
Washington, DC 20547
United States of America

Nga redaktorët

Garancitë kushtetuese të Shteteve të Bashkuara për lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes kanë siguruar një shtyp kryesisht pa ndonjë sistem rregullator prej qeverisë. Kjo nuk nënkupton media pa standarde. Në këtë revistë, ekspertë të shquar të SHBA eksplorojnë rolin qendror të etikës së medias si një vlerë thelbësore që i jep formë gazetarisë funksionuese të SHBA.

Në sistemin amerikan, media jonë e lirë është një burim i domosdoshëm informacioni që përbën zemrën e një shoqërie të lirë. Ky rol kritik e vesh median me pushtetin e vet, i cili, kur përdoret në mënyrë të papërgjegjshme, mund ta kërcënojë një shoqëri të lirë. Atëherë, si e përballojmë ne këtë sfidë?

Në shumë vende, qeveria merr përsipër rolin e rregulluesit parësor të mediave. Në Shtetet e Bashkuara, zgjidhja jonë ka qenë që të mbështetemi te forcat e tregut, konkurrenca, përgjegjësia dhe një sistem shumë i zhvilluar mekanizmesh vetëkontrolli, të cilin e quajmë etikë të gazetarisë.

Etika e gazetarisë ofron një proces me anën e të cilit gabimet dhe teprimet individuale korrigjohen pa rrezikuar objektivin përfundimtar të medias së lirë – sigurimin e një kontrolli të shëndetshëm mbi qendrat e pushtetit në mënyrë që të vazhdojmë ta mbajmë shoqërinë të lirë e të ndriçuar.

Në Shtetet e Bashkuara, mediat elektronike dhe Interneti kanë krijuar një numër të ri sfidash që trajtohen herë pas here në një kuadër rregullator qeveritar, por gjithmonë në kontekstin e parimeve dhe të mbrojtjeve kushtetuese bazë të lirisë së shtypit.

Gazetarët kudo kanë një rol të rëndësishëm në furnizimin e publikut me dije e kuptim. Por gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në një botë që është sa teknologjikisht, aq edhe gjeografikisht në ndryshim, puna e tyre duhet të udhëhiqet prej standardesh sistematike. Vetëm kështu gazetarët mund t'i shërbejnë shoqërisë së tyre në një mënyrë etikisht të përgjegjshme e konstruktive.

FOKUS

Përcaktimi i Hapësirës së Pushtetit të Katërt

Nga Nikolas Xhonson

Profesor i Jashtëm i Drejtësisë, Kolegji i Drejtësisë i Universitetit të Ajouës.

Autor i «Si t'i Përgjigjeni Televizorit Tuaj»

Kushtetuta e SHBA, sistemi i tregut të lirë dhe presupozimi kundër sistemit rregullator i japin formë lirisë së shtypit në Shtetet e Bashkuara.

«Kongresi nuk do të nxjerrë asnjë ligj... që kufizon lirinë e fjalës apo të shtypit...» Amendamenti 1, Karta e të Drejtave, Kushtetuta e SHBA, 1791.

Këto fjalë mishërojnë lirinë e shtypit në Kushtetutën e SHBA, dokumenti që formon strukturën e qeverisë dhe përbën bazën e së drejtës në SHBA.

Duke ndërtuar kuadrin e qeverisjes së SHBA, Kushtetuta përcakton një ekuilibër pushtetesh midis legjislativit, gjyqësorit dhe ekzekutivit (presidenti dhe administrata). Secila degë është e veshur me kompetenca të ndara e të dallueshme, të cilat vendosin një sistem kontrollesh e balancimesh. Etërit Themelues e ngritën në mënyrë skrupuloze këtë arkitekturë qeverisëse për të krijuar një sistem në të cilin shpërndarja e pushtetit nëpër degët e tij do të kontribuonte në stabilitet.

Në vitet e para të republikës kur u hartua ky sistem kontrollesh e balancimesh, ishte formuar prej kohe një bashkësi e guximshme gazetareske. Një shtyp

luftarak e syptrembur përbënte një forcë ndikimplotë për denoncimin e sundimit të një mbreti anglez si dhe për çuarjen e Amerikës koloniale drejt revolucionit të saj kundër Perandorisë Britanike. Duke pasur një liri gazetareske të mbrojtur në Kartën e të Drejtave të vitit 1791, gjatë dekadave të para të ekzistencës kombëtare shtypi u bë një forcë nxitëse. Media në SHBA sot njihet shpesh si Pushteti i Katërt, një përcaktim që flet se shtypi ndan të njëjtën pozitë me degët e tjera të qeverisë të krijuara prej Kushtetutës.

Ligji

Presupozimi kundër sistemit rregullator për shtypin në ligjet e SHBA mund të përshkruhet në pak paragrafë, po për luftërat jo rrallë të ashpra e vragëlënëse që janë zhvilluar për të mbrojtur liritë e shtypit dhe për të kufizuar teprimet e gazetarisë së papërgjegjshme, janë shkruar vëllime të tëra. Në të gjithë këtë histori, për shkak të pavarësisë së tij, gjyqësori ka qenë një partner i domosdoshëm për mbrojtjen e lirisë së shtypit.

Një numër çështjesh gjyqësore kritike kanë qenë momente historike në vendosjen e të drejtave të shtypit qoftë lidhur me dhënien e informacionit

dhe me botimin e dokumenteve qeveritare, qoftë lidhur me dhënien e informacioneve përçmuese për figurat publike. Për shembull, duke lejuar botimin e materialeve që u njohën me emrin Letrat e Pentagonit, Gjykata Supreme e SHBA doli në krah të gazetave, jo të qeverisë. Me gjithë kundërshtimet e qeverisë, gazetat i botuan këto dokumente konfidenciale të Luftës së Vietnamit të marra në rrugë jozyrtare.

Gjykata Supreme e SHBA ka vendosur gjithashtu që media duhet të gëzojë njëfarë mbrojtjeje nga Amendamenti i Parë lidhur me ligjet e shpifjes – në mënyrë që frika nga paditë gjyqësore dhe dëmshtëpërblimet e mundshme monetare të mos ua heqë pronarëve të mediave dëshirën për të raportuar në mënyrë të plotë mbi çështjet publike. Që një figurë publike të fitojë një çështje që ka të bëjë me një shpifje kundër një të padituri të medias, paditësi duhet të vërtetojë një «keqdashje faktike», të cilën gjykatat e kanë përcaktuar ose si dijeni të faktit që deklarata e botuar ishte e rreme, ose si «injomim të papërligjor të faktit nëse ishte e rreme apo jo.»

Pavarësia e mirëfilltë e gjykatësve federalë të SHBA është një faktor kyç në zhvillimin e mbrojtjeje ligjore që gëzon media. Gjykatësit federalë caktohen nga Presidenti dhe miratohen nga Senati. Pasi kanë filluar detyrën, ata mbeten përgjithmonë në detyrë, të mbrojtur në mënyrë specifike prej presionit të jash-tëm të ushtruar nga interesat politike apo nga zyrtarë të degëve ekzekutive e legjislativë. Pagat e gjykatësve nuk mund të ulen dhe është thujtë e pamundur që ata të hiqen nga detyra.

Përveç këtyre parimeve të bazuara në Kushtetutë, për të qeverisur ushtrimin e gazetarisë ekzistojnë pak ligje apo rregulla, në mos fare. Qeveria e SHBA nuk i liçonson gazetarët dhe nuk i kontrollon furnizimet e gazetave me letër apo të shtypshkronjave me bojë. Megjithatë, gazetarët u nënshtrohen të njëjtave ligje që në përgjithësi zbatohen për të gjithë qytetarët. Gazetat, stacionet radiotelevizive dhe gazetarët duhet të paguajnë taksa për shitjet dhe të ardhurat, sikurse edhe biznesmenët dhe qytetarët e tjerë. Sikurse çdo qytetar tjetër, gazetarët mbajnë përgjegjësi përpara ligjit për cënimin e pronës apo për sigurinë në autostradë, pavarësisht nga zelli i tyre për botimin e një lajmi.

Tregu

Ekonomia luan një rol madhor në plazmimin e informacionit që i shërbehet publikut të SHBA në gazeta, radio e televizione dhe tani në Internet. Mediat janë sipërmarrje që nxiten prej fitimit. Megjithëse organizatat jofitimprurëse dhe mbrojtëse kanë një vend të rëndësishëm në mediat e SHBA, shumica e burimeve parësore të informacionit të publikut – gazetat e mëdha të qyteteve, revistat e përjavshme të lajmeve apo rrjetet radiotelevizive dhe kabllore – janë futur në biznes për të fituar para.

Mbrojtjet e garantuara nga Amendamenti i Parë nuk shtrihen drejtpërdrejt te gazetarët që mbledhin lajmet, por te pronarët e agjencive të mediave që i shpërndajnë këto informacione. Pronarët e mediave e kanë në dorë vetë për t'u dhënë liri të mëdha redaktorëve e reporterëve të tyre. Një gjë të tillë ata mund ta quajnë biznes të mirë – dhe gazetari të mirë. Por kjo është çështje dëshire, jo çështje ligji. Gazetarët e një gazete nuk kanë më shumë të drejta ligjërish të zbatueshme që artikujt e tyre të botohen nga ç'kanë të drejtë lexuesit që të botohen letrat e tyre – apo, për këtë arsye, që të blejnë hapësirë në një gazetë për të promovuar një pikëpamje, të cilën pronari ka dëshirë ta censurojë.

Në bazë të gjykimit të Gjykatës Supreme të SHBA, e drejta për të folur që garanton Amendamenti i Parë përfshin të drejtën e pronarit të medias për të censuruar fjalën e kujdto tjetër në median e tij apo të saj. Kjo është e vërtetë edhe sikur në një qytet të ketë vetëm një gazetë apo vetëm një stacion radioje apo televizioni. Hollë-hollë, të vetmit qytetarë që e gëzojnë të drejtën absolutisht të pakufizuar sipas Amendamenti të Parë për të përhapur pikëpamjet e tyre në shtyp janë ata pak njerëz që zotërojnë media.

Megjithatë, konsumatorët e lajmeve në SHBA, të cilët, në mes të morisë së produkteve gazetareske që janë në dispozicion në tregun e informacionit, janë të aftë të gjykojnë paanshmërinë dhe saktësinë e raportimit, i kufizojnë kompanitë e medias që të mos përhapin lajme që pasqyrojnë vetëm qëndrimet e njëanshme dhe agjendat e tyre. Këta qytetarë të mençur në lëmin e medias reagojnë shpejt ndaj ansshmërive dhe gabimeve që shfaqen në njoftimet në gazeta apo në transmetime. Kështu, ata pronarë mediash që përpiqen ta shtrembërojnë pasqyrimin e

lajmeve për të reflektuar anshmëritë e tyre në to rrezikojnë të humbasin auditorin dhe, nëse humbet auditori, humbasin edhe të ardhurat që vijnë prej reklamuesve që dëshirojnë ta arrijnë atë auditor.

Gazetat dhe disa rrjete radiotelevizive dikur ndiheshin krenare për «murin» midis sektorëve të reklamave dhe të lajmeve. Disa kritikë pohojnë se ky mur ka ardhur duke u shembur. Kjo ka ndodhur pjesërisht si rezultat i bashkimit të mediave të shumta e të larmishme në pak e më pak duar korporative. Kundërshtarët e këtij konsolidimi korporativ tremben se një departament lajmesh i një rrjeti nuk do të pranohet më si një humbje financiare që e kompenson koston e vet me prestigjin që ofron. Sot bordet drejtuese të korporatave mund t'i shohin lajmet thjesht si një tjetër «qendër fitimesh» me një ndikim kontribues në «rezultate» dhe në çmimin e aksioneve.

Balancimi i çmimit të një gazetarie shumë cilësore me përfitimet korporative është një prej sfidave më të mëdha në gazetarinë e sotme të SHBA. Kur bizneset përpiqen të hedhin në gjyq shkrime kritike të gazetarisë investiguese apo të anulojnë reklama, një redaktor apo drejtor lajmesh do të mendohet mirë nëse do ta botojë apo jo një lajm provokues, pasi kjo i rrezikon humbjen e të ardhurave, apo edhe humbjen e vendit të punës së tij apo të saj. Kështu që vetëcensura që rrjedh nga kjo dilemë, apo edhe nga të tjera, mund të jetë forma mbizotëruese e censurës që ndikon sot në përmbajtjen e mediave në SHBA.

Valët Radiotelevizive

Mediat e shkruara dhe elektronike kanë të njëjtat liri gazetareske që garantohen prej Amendamentit të Parë. Megjithatë, për shkak të privilegjit për të përdorur valët e transmetimit publik, drejtuesit e radiove dhe të televizioneve u nënshtrohen disa rregullave qeveritare, të cilat nuk imponohen mbi kolegët e tyre të shtypit të shkruar. Akti i Radios i vitit 1927, ligji i parë që qeveris median elektronike, pasqyron kufizimet fizike në grupin e bandave të frekuencave. Jo cilido që dëshiron të transmetojë mund ta bëjë këtë, sepse sinjalet do të ndërhyjnë tek njëri-tjetri dhe nuk do mund t'i ofrohej shërbim auditorit.

Në vitet 1920 dhe 1930, në kohën kur në SHBA po merrnin formë politikat kombëtare, ky vend, ndryshe nga shumica e vendeve të tjera, vendosi që sta-

cionet të mos zotëroheshin dhe të drejtoheshin nga një agjenci qeveritare apo korporatë publike me financim nga qeveria. Përkundrazi, për këtë media të re u zgjodh një sistem hibrid. Pajisjet e një stacioni mund të ishin pronë private, por e drejta e tij për të transmetuar do të rregullohej nga qeveria dhe do të kufizohej me licensë.

Komisioni Federal i Komunikacionit (FCC), i ngritur më 1934, është agjencia rregullatore e SHBA që përgjigjet për lëshimin e licensave të transmetimit radiofonik si dhe për të këqyruar nëse licencat i shërbejnë «së mirës, interesit dhe nevojës publike.» Në vitet e para, për të fituar privilegjin e zotërimit të një license, kërkohet që pronari i stacionit ta kufizonte sasinë e reklamave dhe të ofronte një gamë programesh – përfshirë një sasi të madhe lajmesh e trajtimesh të çështjeve publike. Përveç kësaj, nuk ekzistonte thujse kurrfarë ndërhyrjeje tjetër në përmbajtje.

Gjatë 30 viteve të fundit është ecur drejt heqjes së rregullimeve në mediat radiotelevizive. Sot FCC në thelb nuk imponon asnjë standard të rëndësishëm programimi në lidhje me sasinë apo cilësinë. Kjo agjenci i ka hequr rregullat e mëparshme që kufizonin numrin e stacioneve që mund të zotëronte një pronar në ndonjë qytet, kurse korporatat individuale, të cilat kryesisht kanë zëvendësuar individët e licensuar, mund të zotërojnë licensa për qindra stacione radioje e televizioni.

Kritikët pretendojnë se sa më i vogël të jetë numri i të licensuarve, aq më pak llojshmëri do të ketë në programet radiotelevizive. Për shembull, duke blerë zinxhirë radiostacionesh, korporatat kanë për prirje që ta homogjenizojnë zërin e tyre duke u ofruar më pak programe auditorëve lokalë.

Vigjëluesit

Duke pasur parasysh rolin qendror të gazetarisë së pavarur në një shoqëri demokratike si dhe mungesën e një rregullatori të përhershëm, qytetarët, grupet e interesave dhe shoqatat gazetareske kanë ndërmarrë përpjekje të pavarura, joqeveritare, për të monitoruar e raportuar mbi cilësinë e mediave. Sigurisht, asnjë prej tyre nuk ka ndonjë fuqi ligjore me peshë të madhe, por ato janë të dobishme për përforcimin e parimeve të ndershmërisë, vërtetësisë dhe saktësisë në pasqyrim.

Për më tepër, shumë botime e kanë parë të dobishme krijimin e postit të avokatit qytetar, një punonjës gjysmë i pavarur, të cilit lexuesit mund t'i paraqesin ankesat e tyre mbi botimin dhe cilësinë e pasqyrit të lajmeve në të. Avokati qytetar mund të japë njoftime në faqet e botimit për këto ankesa si dhe për mënyrën se si janë zgjidhur.

Pak institucione janë më të rëndësishme për një demokraci sesa mediat e lira e të pavarura. Një liri e tillë kërkon prej publikut, zyrtarëve të zgjedhur dhe organizatave civile që të mbështetin të vërtetën, ndershmërinë dhe paanshmërinë në pasqyrim si dhe të këmbëngulin që organizatat e medias të respektojnë parimet që i bëjnë ato të fuqishme.

Nikolas Xhonson, ish-komisioner në Komisionin Federal të Komunikacionit, sot jep mësim në të drejtën e komunikimit në Kolegjin e Drejtësisë të Universitetit të Ajouës në Ajoua Siti, shteti Ajoua. Ka një faqe në Internet me adresën nicholasjohnson.org

Roli i Medias në Ndërtimin e Bashkësisë

Nga Jan Shefër

Drejtor Ekzekutiv

Qendra Pju për Gazetarinë Qytetare (Pew Center for Civic Journalism)

Autori mbron një lloj të ri gazetarie – atë që i ndihmon njerëzit të kapërcejnë ndjenjën e pafuqisë dhe të tëhuajimit duke i sfiduar ata që të përfshihen, të angazhohen dhe të bëhen zotërues të problemeve të komuniteteve.

Gjashtë vjetët pas krijimit të Qendrës Pju për Gazetarinë Qytetare, gazetaria qytetare ka bërë një përparim të madh. Dy gjëra tani i dimë mirë:

Kur media e bën detyrën e vet në mënyrë jo të rëndomtë, edhe qytetarët i bëjnë detyrat e tyre në mënyrë jo të rëndomtë.

Kur në studiot e lajmeve mbillet risi, lindin ide të reja.

Sot në Shtetet e Bashkuara jetojmë në një epokë në të cilën si gazetarët, ashtu edhe publiku luftojnë për të arritur në një mendje se ku konsiston gazetaria e mirë.

Nuk mjafton më që vetë gazetarët të mendojnë se po bëjnë një punë të mirë. Që gazetaria të vazhdojë të përfitojë mbrojtje kushtetuese – si dhe të vazhdojë të tërheqë lexues e shikues – duhet që lexuesit e shikuesit të bashkëpajtohen që gazetaria luan një rol thelbësor në shoqërinë tonë demokratike.

Megjithatë, kohët e fundit kemi të dhëna shqetësuese se nuk është kështu. Sondazhet kombëtare dokumentojnë një rezervuar pakënaqësie ndaj shtypit amerikan dhe praktikave të tij. Fjalët që përdor publiku për të karakterizuar mediat janë: arrogante, të pandjeshme, të njëanshme, të pasakta dhe sensacionale.

Duket se ka një bashkëpajtim në rritje sipas të cilit «puna me lajmet» është prishur. Tani pyetja e madhe është: a dinë gazetarët ta ndreqin?

Tirazhi i gazetave qëndron në vend ose po bie. Njerëzit vërtet lexojnë më shumë, po jo gazeta. Shikueshmëria e lajmeve të televizionit po bie.

Freedom Forum, një fondacion jopartiak ndërkombëtar, kohët e fundit zhvilloi një sondazh lidhur me gjendjen e Amendamentit të Parë. Në përgjithësi, të drejtat që garanton Amendamenti i Parë shtypi i vlerësonte më shumë nga ç’i vlerësonte publiku i gjerë.

- Më shumë se gjysma e njerëzve që iu përgjigjën sondazhit – 53 përqind – thanë se sipas tyre shtypi ka tepër liri. Kjo përfaqëson një rritje prej 15 përqind në krahasim me një sondazh të tillë në vitin 1997.
- Vetëm 45 përqind, nga 54 përqind në vitin 1985, besonin se media mbron demokracinë. Kurse 38 përqind thanë se media në fakt e dëmton demokracinë.
- Rreth 65 përqind thanë se gazetatat nuk duhet të botojnë lirisht.
- Një numër relativisht i madh njerëzish thanë se shtypi nuk duhet lejuar të mbështesë apo të kritikojë kandidatë politikë, nuk duhet të përdorë kamera të fshehta për të mbledhur lajme dhe nuk duhet të botojë sekrete të qeverisë.

Ç’Mund të Bëjmë?

Këto shifra përbëjnë lajme shqetësuese për gazetarët. Madje mendoj se përbëjnë lajme shqetësuese edhe për publikun.

Ç'mund të bëjmë për këtë? Një nga gjërat që po bëjmë ne, në Qendrën Pju, është se po përpiqemi të shkojmë përtej diagnostikimit të thjeshtë të problemit; në fakt ne po paraqesim disa receta për zgjidhje. Në të vërtetë, shumë gazetarë ndihen më rehat me diagnoza sesa me receta, por reagimet që hasim në kërkimet tona janë aq të shumta, saqë edhe redaktorët më kokëfortë po fillojnë të thonë «mjaft.» Po përpara se të mund t'i ndreqim gjërat, duhet të gjejmë se çfarë kërkojmë të jemi. Cili është roli ynë në ndërtimin e komunitetit?

Modelet e vjetra të gazetarisë, sidomos ato të gazetave lokale e rajonale, shpesh etiketoheshin si «këlyshë» nën kontrollin e botuesve që kishin dalë si mbrojtës të qytetarisë, por që në fakt rendnin pas dollarëve nga reklamat.

Por tani, duke patur parasysh një pjesë të mbulimit me lajme të presidencës së Klintonit si dhe imazhet e fotoreporterëve që fshiheshin pas shkurreve të shtëpisë së familjes Kenedi pas vdekjes së Xhon F. Kenedi të Riut, modeli që të vjen më shpesh në mend është «qen sulmues».

Pastaj është edhe modeli «qen roje,» të cilin gazetarët hiqen se respektojnë. Ky është një rol që ende vlerësohet nga komuniteti i gazetarëve. Por publiku po shpreh përherë e më shumë dyshime për këtë rol, madje edhe gazetarët janë dakord që shtypi shpesh bën më shumë sesa thjesht pasqyrimin e lajmeve – shpesh nxit polemika, sidomos duke evidentuar sjelljet vetjake dhe etike të figurave publike.

Disa prej kërkimeve më të fundit tregojnë se shtypi e vlerëson rolin e vet prej qeni roje më shumë se publiku. Vetëm 10 përqind e mediave të lajmeve besojnë se kritikantët e shtypit ndaj udhëheqësve politikë i pengojnë këta të fundit të kryejnë punën – porse 31 përqind e publikut beson se shtypi i pengon udhëheqësit të kryejnë punën.

Sot janë duke u vënë në provë disa modele të reja. Njëri është ai i «qenit drejtues.» A mund të ekzistojë një gazetar që jo vetëm u jep njerëzve lajme e informacione, por edhe i ndihmon të kryejnë detyrat e tyre si qytetarë? Që jo vetëm i njuh njerëzit me çudirat e ditës, por edhe i sfidon të përfshihen, të angazhohen dhe të bëhen zotër të problemeve? Që nuk i vë në pozitën e spektatorëve, por edhe të pjesëmarrësve?

Pikërisht këtu gazetaria qytetare u ka dhënë shtysën eksperimenteve të shumta. Gazetaria qytetare nuk mbron braktisjen e rolit të qenit roje, por, përkundrazi, i shton këtij roli përgjegjësi të mëtejshme.

Qendra Pju për Gazetarinë Qytetare (Pew Center for Civic Journalism)

Kur organizata Pew Charitable Trusts vendosi të krijonte Qendrën Pju për Gazetarinë Qytetare, ajo nuk kishte për objekt gazetarinë; fokusi i saj ishte angazhimi qytetar. Kjo organizatë ishte e shqetësuar që demokracia ishte prishur – që qytetarët nuk votonin, nuk dilnin vullnetarë dhe nuk merrnin pjesë aktivisht në jetën qytetare; që njerëzit nuk dilnin për të dhënë ndihmë në trajtimin e problemeve në bashkësitë e tyre.

Kjo organizatë vriste mendjen se mos ndofta gazetaria ishte pjesë e problemit. Mos media i trajtonte njerëzit si spektatorë në një shfaqje çudirash qytetare, në vend që t'i trajtonte si pjesëmarrës aktivë të një shoqërie vetëqeverisëse?

Ndaj ajo ngriti një hipotezë të thjeshtë: nëse gazetarët do t'i bënin punët e tyre ndryshe nga rutina, a do t'i bënin edhe qytetarët punët e tyre po ashtu? A mund të praktikojmë ne disa eksperimente nëpër studiot e lajmeve për të parë nëse mund të gjenim modele të tjera, modele që vazhdojnë t'u qëndrojnë vlerave bazë të gazetarisë – saktësisë, objektivitetit, pavarësisë, ndershmërisë – por që janë gjithashtu të dobishme për qytetarët?

Tani gazetaria qytetare është një etiketë e gjerë që u vihet përpjekjeve të redaktorëve dhe të drejtorëve të lajmeve, të cilët synojnë që ta kryejnë punën e tyre si gazetarë sipas mënyrave që ndihmojnë në kapërcimin e ndjenjës së mungesës së pushtetit dhe të mënjanimin që kanë njerëzit. Ajo synon edukimin e qytetarëve për çështje dhe ngjarje aktuale në mënyrë që ata të marrin vendime qytetare, të angazhohen në dialog e në veprime qytetare dhe përgjithësisht të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në demokraci.

Gazetarët qytetarë besojnë se është ende e mundshme që të krijohet një pasqyrim lajmesh që i nxit njerëzit të mendojnë, madje edhe të veprojnë, në vend që thjesht t'i joshin për të qenë spektatorë. Ata besojnë se është përgjegjësi e tyre për ta bërë këtë.

Megjithatë, dua të tërheq vëmendjen se gazetaret qytetarë nuk synojnë t'u thonë lexuesve dhe shikuesve se çfarë të mendojnë apo si të veprojnë. Ata thjesht po krijojnë një zonë asnjansë fuqizimi duke i armatosur qytetarët me informacion dhe hera-herës edhe me metoda për t'u vënë shpatullat një pjese të përgjegjësive si dhe për të kontribuar me imagjinatë apo me zgjidhje për ndreqjen e një problemi.

Gazetarët qytetarë besojnë se mund të jesh një qen drejtues pa e braktisur rolin e qenit roje. Dhe të gjithë janë më se të lumtur që ta braktisin rolin e qenit sulmues.

Në varësi të pikëpamjes individuale, kjo është ose kthim në themelet e gazetarisë së mirë, ose një këndvështrim i ri revolucionar ndaj raportimit të lajmeve. Unë personalisht besoj se është më shumë se gazetari e mirë, të paktën është gazetaria që unë kam praktikuar për 22 vjet në *Philadelphia Inquirer*.

Ajo përdor të gjitha mjetet e gazetarisë së mirë dhe nuk ka frikë të angazhohet akoma më shumë me bashkësinë – duke dëgjuar, duke qenë katalizator veprimesh dhe duke e ndihmuar bashkësinë që të arrijë kapacitetin e vet. Dhe nuk ka frikë të thotë: nëse gazetaria e vjetër nuk funksionon, le ta rishpikim.

Ç'Është Lajmi?

Një nga mënyrat në të cilën gazetaret qytetarë përipiqen të bëjnë një «gazetari të ndryshme» është të kërkuarit e përkufizimeve të reja për lajmin. Shumica e gazetarëve e përkufizojnë lajmin si konflikt: titullari kundër sfiduesit, fituesi kundër humbësit, pro-ja kundër të kundërtës.

Gazetaria qytetare synon që ta zgjerojë këtë përkufizim. Ajo kërkon të shkojë përtej pasqyrit të një aktiviteti, takimi apo polemike. Përipiqet të përcjellë dije, jo thjesht dhënie lajmesh. Ka të bëjë me pasqyrimin si të konsensusit, edhe të konfliktit, si të historive të suksesit, edhe të dështimeve – lajme që mund të ndihmojnë bashkësi të tjera për përballuar çështje të vështira.

Gazetaria qytetare përipiqet të formojë disa modele të reja raportimi që mund të jenë më të bashkërenduara me modelet e reja të qeverisjes. Për zgjidhjen e problemeve vendore, shumë skenarë të qeverisjes

vendore po i largohen paradigmës fitoj-humb duke ecur drejt një përqsasjeje me një bazë më të madhe konsensusi: të llojit fitoj-fitoj.

Si duhet të pajiset gazetaria për ta trajtuar këtë? Ne po bëjmë goxha punë për të pasqyruar konfliktin, për të gjurmuar e mbajtur shënim fituesit dhe humbësit. Por, pa dërgoni një reporter për të pasqyruar një takim në të cilin të gjithë bien dakord për diçka dhe ai ose ajo ka gjasa të kthehet e t'i thotë redaktorit që «nuk ndodhi asgjë.» Nuk ka lajm.

Gazetarët qytetarë kërkojnë të shqyrtojnë se për çfarë bien dakord lojtarët e bashkësisë dhe për çfarë nuk bien dakord. Kjo është gjë e re.

Një prej eksperimenteve më ambicioze të Qendrës Pju u ndërmor në Spokejn të Uashingtonit më 1999, kur gazeta *Spokesman Review* përdori mjetet «projektuese» të gazetarisë qytetare për të bërë diagramën e momenteve kyçe në jetën e të rinjve, mjete që përcaktojnë nëse ata do të kenë sukses apo do të dështojnë në jetë, madje nëse ndoshta do të përfundojnë në burg apo jo. Këto eksperimente nxorën në pah disa çaste interesante – për shembull, dita e parë e klasës së katërt është dita që ju jep të kuptoni nëse një fëmijë do ta pëlqejë shkollën apo jo. Ose, dita e parë e klasës së shtatë është dita kur përcaktohet nëse dikush do të jetë «gjeni» apo «pjesë» e turmës.

Idea nuk ishte vetëm që të trajtohej kjo temë, por edhe të zbuloheshin disa pika ndërhyrjeje për agjencitë e shërbimeve sociale në bashkësi. Ky është një përkufizim shumë i ndryshëm i «lajmit.»

Gazetaria qytetare ka të bëjë me ristrukturimin e lajmeve për t'i bërë më të lidhura me lexuesit.

Gazeta *Orange Country Register* në Kaliforni eksperimentoi një teknikë të re narracioni për të treguar historinë e «Fëmijëve të Moteleve» – fëmijë tejet të varfër që jetonin në motele rezidenciale pikërisht në anën tjetër të rrugës së parkut Disneyland. Historia u tregua në formë dialogu, duke përdorur fjalët e vetë fëmijëve.

Përgjigjja ishte fuqishme. Ajo përfshiu 200.000 dollarë donacione, 50 tonë ushqime, 8.000 lodra dhe mijëra orë pune vullnetare kushtuar ndihmës për «Fëmijët e Moteleve.» Komuna akordoi 1 milion

dollarë për një program strehimi për t'i nxjerrë familjet nga motelet. Një agjenci jopërfituese nisi një fushatë 5-milionë dollarëshe për të trajtuar abuzimin me drogë në familjet e moteleve.

Reporterja Laura Saari tha më pas se ajo çka e kishite habitur më shumë ishte se si secili punonte së bashku me të tjerët për gjetjen e një zgjidhjeje. «Një lajm i ngjashëm, i treguar në mënyrën e zakonshme, do t'i kishte bërë agjencitë qeveritare që të kalonin në pozita mbrojtjeje. Po për shkak të mënyrës së të shkruarit, askush nuk ndihej si i akuzuar. Kështu, në vend që të humbnin energji për t'u vetëmbrojtur, ata dolën në rrugë.»

Gazetaria qytetare ka të bëjë me ripërkufizimin e balancës.

Gazetarët raportojnë dy anë të një historie dhe besojnë se kjo është një mënyrë e ndershme dhe e balancuar. Gazetarët qytetarë sugjerojnë se termi më i përshtatshëm është pasqyrimi dyqolar, jo i balancuar. Balanca është në mes, jo në ekstreme. Gazetarët qytetarë përpiqen të bëjnë të mundur që të gjithë njerëzit e prekur nga çështja të kenë zërin e tyre në lajm dhe jo t'u dëgjohet zëri vetëm ithtarëve të pikëpamjeve më ekstreme që na dërgojnë njoftimet e tyre të shtypit. Dhe gazetarët qytetarë nuk kanë frikë të raportojnë për paqartësinë, për rastet kur njerëzit ende përpiqen të gjejnë se si ndihen.

Së fundi, gazetaria qytetare ka të bëjë me sigurimin e pikave kyçe qoftë për të aktivizuar njerëzit, qoftë për të nxitur ndërveprueshmërinë midis gazetarëve e qytetarëve. Ajo përpiqet të krijojë bisedime dykalishe me lexuesit, ndryshe nga zbrazja njëkalishe e informacionit – e derdhjes së shumë fakteve në publik – gjë që shihet aq shpesh në gazetarinë tradicionale.

Ky ndërveprim mund të kryhet në faqet e lajmeve, në transmetimet radiotelevizive, në Internet e herëherë edhe në hapësirën faktike – në forume e takime në bashki. Ndërsa pasqyrojnë një çështje të rëndësishme që kishte të bënte me transportin e nxënësve të shkollave me autobusë, gazeta *Charlotte Observer* e Karolinës së Veriut zbuloi se idetë për një pasqyrim më të mirë vinin me postë elektronike nga lexuesit.

Në vitin 1999, Qendra Pju mbështeti një program në Radion Publike të Nju Hempshërit (WHPR) në lidhje me një Përlllogaritës Taksash në Internet. Gjykatat e kishin urdhëruar këtë shtet pa taksa që të gjente një taksë për të financuar shkollat publike.

Faqja e Internetit e Sfidës së Taksës e WHPR përmbante informacion edukativ, hapësirë diskutimi, një dritare të volitshme që u krijonte njerëzve mundësinë për të deklaruar vlerën e shtëpisë së tyre, të ardhurat që kishin, emrin e qytetit ku banonin si dhe mundësinë për të llogaritur realisht se sa do t'u kushtonin atyre të tri propozimet e ndryshme për reformën e taksave.

Kjo ishte një gazetari shumë e ndryshme, e përshtatur, e individualizuar dhe e dobishme që i fuqizonte njerëzit të luanin një rol në zgjedhjen e një politike publike. Kohët e fundit, Qendra Pju financoi stacionin WHPR për të ndërtuar një Vlerësues të Faturave të Shërbimeve Komunale si një mënyrë për ta bërë çështjen e liberalizimit të shërbimeve komunale më të arritshme nga njerëzit.

Rezultatet

Atëhere, cilat janë rezultatet e gazetarisë civile?

Për bashkësinë:

- Shikojmë se tani ajo ka një gazetari cilësore që përmirëson aftësinë e bashkësisë për zgjidhjen e problemeve.
- Shikojmë se kur lexuesit pajisen me mjetet për të vepruar, ata veprojnë.
- Në kërkime kemi vënë re se përpjekjet për një gazetari qytetare sjellin një rritje të njohurive të lexuesve mbi një çështje të caktuar në përpjesëtim të drejtë me këto përpjekje.
- Kemi vënë re se përpjekjet për një gazetari qytetare ndikojnë pozitivisht në perceptimin e njerëzve për median.

- Kemi parë grupe të tjera komunitare të adoptojnë modelin e angazhimit qytetar (për shembull, në rrethe studimi dhe ekupe veprimi), model që e kanë mësuar nga angazhimi i institucioneve të medias në përpjekjet e gazetarisë qytetare.
- Kurse tani po fillojmë të shikojmë se si njerëz të ndryshëm po kandidojnë për poste të fituara me vota, njerëz që kur ende nuk ishin përfshirë në nismën e gazetarisë qytetare, nuk kishin dashur kurrë të bëheshin zyrtarë.

Për gazetarinë:

- Ndryshe nga gazetaria që pasqyron mekanikisht dy anët e një çështjeje, tani shikojmë një pasqyrim më të thellë, me një rezonancë më autentike me bashkësinë.
- Shikojmë gazetarë që po i rizbulojnë bashkësitë e tyre – dhe po u shkaktojnë krisje disa stereotipeve.
- Shikojmë gjithfarëlloj risish në dhomat e lajmeve. Faqe të reja, vende të reja pune, kritere të reja, deklarime misionesh të reja. Një fjalor të ri. Në gazetën *Virginian Pilot* në Norfolk, deklarata e misionit e gazetarëve të saj që mbulojnë Richmondin, kryeqytetin e shtetit të Virxhinias, premtan të pasqyrojë qeverinë e shtetit dhe zgjedhjet «si një ushtrim në zgjidhjen qytetare të problemeve.»

- Së fundi, gazetaria qytetare ka prodhuar një mjedis që i ka lejuar redaktorët të marrin në sy reziqe të reja.

Unë nuk mendoj se gazetaria qytetare i ka të gjitha përgjigjet për gjithçka që nuk shkon mirë në media. Por ajo mund të marrë një pjesë të madhe të krenarisë për sugjerimin e disa ndreqjeve. Dhe, siç këshillonte Shën Pali në një prej letrave të tij, ne besojmë se kemi nevojë që «t'i provojmë të gjitha gjërat dhe të lidhemi fort pas gjithçkaje që është e mirë.»

Qendra Pju nxit eksperimente të gazetarisë qytetare, të cilat u mundësojnë organizatave të krijojnë dhe t'i përsosin mënyrat për raportimin e lajmeve duke ndihmuar kështu riangazhimin e njerëzve në jetën publike.

Pse i Nevojitet Demokracisë Gazetaria Investiguese

Nga Silvio Ueisbord

Autor i «Gazetaria Vigjëluese në Amerikën e Jugut: Lajmet, Përgjegjshmëria dhe Demokracia.»

Megjithëse në ditët e sotme trysnitë e biznesit dhe kërcënimi nga paditë e kushtueshme bëjnë që disa kompani lajmesh të mos kenë dëshirë ta mbështetin raportimin hulumtues, ky zhanër gjithsesi mbetet një forcë e madhe në gazetarinë e SHBA dhe të Amerikës Latine – si dhe një prej kontributeve më të rëndësishme të shtypit në demokraci.

Në vitet 1970, gazetarët luajtën role kritike në zbulimin e asaj që u bë skandali politik më serioz i SHBA në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Gazetarët e Uashingtonit gjurmuan shenjat e një vjedhjeje të vogël në ndërtesën Uotergejt të zyrave, duke i ndjekur ato deri në Shtëpinë e Bardhë. Reportazhi çoi në hetime nga Kongresi dhe në fund në dorëheqjen e Presidentit Riçard Nikson.

Funksionimi i shtypit gjatë procesit Uotergejt është konsideruar si një pasqyrë që reflektoi gjënë më të mirë që gazetaria mundi t'i ofrojë demokracisë: vënie e pushtetit përpara përgjegjësisë. Kjo u bë rrymë në dhomat e lajmeve në Amerikë. Ky profesion gëzoi besueshmëri të lartë në vitet që pasuan dhe shkaktoi një rritje të ndjeshme në numrin e studentëve të shkollave e gazetarisë.

Por rreth tri dhjetëvjeçarë më vonë situata ndryshoi. Gazetaria investiguese nuk duket se është ylli më i shndritshëm në qiellin e lajmeve në Amerikë. Nëse në vitet e pas-Uotergejtit toni i shtypit ishte vetëpërgëzues, sot pesimizmi mbi gjendjen e gazetarisë amerikane është shumë i përhapur. Shpesh vëzhguesit kanë argumentuar se përqendrimi në rritje i pronësisë së mediave dhe nxitja për të sensacionalizuar

pasqyrimin e lajmeve e kanë dobësuar vrullin që kërkon raportimi hulumtues.

Edhe trysnitë e biznesit e shkurojnë raportimin hulumtues. Kërkesat e tij për një sasi të madhe kohe, burimesh njerëzore e financiare shpesh bien ndesh me parashikimet për fitime si dhe me kontrollin e kostos së prodhimit. Gjithashtu, fakti që artikujt mund të rezultojnë në padi të kushtueshme i bën kompanitë e lajmeve që t'i tremben mbështetjes së hulumtimeve.

Pavarësisht nga këta faktorë, artikujt hulumtues gjatë dhjetëvjeçarit të fundit nuk kanë munguar aspak. Gazetat kryesore qytetëse në Shtetet e Bashkuara kanë botuar artikuj që kanë zbuluar korrupsion, padrejtësi dhe keqadministrim të mjedisit. Televizionet lokale dhe kombëtare publikojnë shpesh lajme investiguese që përgjithësisht përqendrohen në lloje të ndryshme mashtrimesh ndaj konsumatorëve në fusha të tilla si shërbimet shëndetësore, shërbimet sociale dhe hipotekimet e banesave.

Ç'Është Gazetaria Investiguese?

Raportimi hulumtues është i veçantë për faktin se publikon informacione në lidhje me kundërvajtjet që kanë ndikim mbi interesat e publikut. Denoncimet vijnë si rezultat i punës së reporterëve dhe jo nga informacionet që depërtojnë fshehurazi në dhomat e lajmeve.

Ndonëse gazetaria investiguese dikur lëvrohej nga gazetarë individualë që kishin pak, në mos aspak, mbështetje prej agjencive të tyre të lajmeve, shembujt e kohëve të fundit tregojnë se puna kolektive

është themelore. Nevojiten lloje të ndryshme ekspertizmi për të prodhuar lajme të mirëdokumentuara e të plota. Për kryerjen e hulumtimeve duhet të punojnë reporterët, redaktorët, specialistët ligjorë, analistët statistikorë, bibliotekarët dhe studiuesit e lajmeve. Njohja e ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtën e publikut për informacion është me rëndësi parësore për të gjetur se ç'loj informacioni supozohet të vihet në dispozicion sipas ligjeve të «lirisë së informacionit» dhe se çfarë problemesh ligjore mund të dalin kur botohet një informacion që dëmton një palë të caktuar. Teknologjitë e reja janë jashtëzakonisht të volitshme për të gjetur fakte dhe për t'i njohur reporterët me kompleksitetet e një ngjarjeje të caktuar. Falë kompjuterizimit të dokumenteve qeveritare dhe sasive të jashtëzakonshme të informacionit në Internet, njoftimi me ndihmën e kompjuterave është shumë i dobishëm.

Demokracia dhe Gazetaria Investiguese

Gazetaria investiguese ka rëndësi për shkak të kontributeve të saj të shumta në qeverisjen demokratike. Roli i saj mund të kuptohet në përputhje me modelin e shtypit si Pushteti i Katërt. Sipas këtij modeli, duke botuar informacion mbi çështje me interes publik dhe nëse një informacion i tillë zbulon abuzime apo krime të shkaktuara prej pushtetarëve, shtypi duhet ta bëjë qeverinë të japë llogari. Nga kjo pikëpamje, raportimi hulumtues është një prej kontributeve më të rëndësishme që shtypi i jep demokracisë. Ai lidhet me logjikën e kontrolleve dhe të balancimeve në sistemet demokratike. Ai siguron një mekanizëm të vlefshëm për mbikëqyrjen e funksionimit të institucioneve demokratike, të cilat, sipas përkufizimit të tyre më të gjerë, përfshijnë organizmat qeveritare, organizatat qytetare dhe korporatat me financim publik.

Rëndësia parësore e medias në demokracitë bashkëkohore i bën elitat politike të jenë të ndjeshme ndaj lajmeve, sidomos ndaj lajmeve «të këqia» që shpesh shkaktojnë trazim publik. Botimi i lajmeve mbi kundërvajtjet politike dhe ekonomike mund të shkaktojë hetime kongresionale e gjyqësore.

Në rastet kur institucionet qeveritare nuk kryejnë hulumtime të mëtjshme, ose kur hetimet ngërthejnë probleme e dyshime, gazetaria mund të kontribuojë

ndaj kërkesës së llogarisë duke mbikëqyruar funksionimin e këtyre institucioneve. Ajo mund të shqyrtojë se në ç'shikallë i përmbushin faktikisht këto institucione mandatet e tyre kushtetuese për të qeverisur në mënyrë të përgjegjshme përballë raportimeve të shtypit që zbulojnë keqfunksionim, pandershmëri apo kundërvajtje në qeveri e shoqëri. Më e pakta që mund të bëjë gazetaria investiguese është pushteti i saj i rëndësishëm në përcaktimin e agjendave për t'i kujtuar qytetarët dhe elitat politike për ekzistencën e çështjeve të caktuara. Megjithatë, nuk ka garanci që vëmendja e vazhdueshme e shtypit do të çojë në veprime kongresionale apo gjyqësore për të hetuar e ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për kundërvajtjet.

Por gazetaria investiguese kontribuon për demokracinë edhe duke ushqyer një qytetari të informuar. Informacioni është një burim jetësor për të fuqizuar një publik vigjilent që tekefundit i kërkon llogari qeverisë përmes votimeve dhe pjesëmarrjes. Me vënien e politikës në qendër të vëmendjes së medias në demokracitë bashkëkohore, mediat i kanë eklipsuar institucionet e tjera shoqërore si burimi kryesor i informacionit mbi çështje dhe procese që ndikojnë në jetën e qytetarëve.

Mundësia e Publikut për Njohje

Mundësia e njohjes së publikut me dokumentet dhe ligjet që bëjnë të mundur kryerjen e punës publike në sesione të hapura është e domosdoshme për punën e një gazetari hulumtues. Nëse në horizont nis të shfaqet censura paraprake apo ligjet për shpifjen, ka pak gjasa që organizatat e mediave të merren me çështje të diskutueshme për shkak të padive potencialisht të kushtueshme. Për pasojë, demokracitë duhet të plotësojnë disa kërkesa të caktuara në mënyrë që gazetaria investiguese të jetë e efektshme dhe të ofrojë një informacion të shumëllojshëm e të plotë.

Etika e Gazetarisë Investiguese

Ekipe të reporterëve hulumtues i ndjekin ngjarjet që hulumtojnë në rrethana të ndryshme, kështu që krijimi i një udhëzuesi të përgjithshëm etik është i vështirë, megjithëse disa standarde të caktuara janë pranuar përgjithësisht. Implikimet ligjore të veprimeve

të gazetareve janë shumë më të qarta se çështjet etike. Nëse ligji e miraton një veprim, ai është i ligjshëm; nëse jo, nuk është.

Etika, nga ana e saj, merret me mënyrën e dallimit midis së drejtës dhe së gabuarës, ku parimet filozofike përdoren për të justifikuar një mënyrë të caktuar veprimi. Në varësi të kuadrit etik që përdoret për të përligjur një vendim si dhe të faktit se cilave vlera u jepet përparësi, çdo vendim mund të gjykohej si etik. Ajo që duhet të vendosin gazetarët dhe redaktorët është se kush do të përfitojë si pasojë e raportimit.

Nëse gazetaria i është përkushtuar kërkesës demokratike të llogarisë, pyetja që duhet bërë është nëse përfiton publiku si rezultat i njoftimeve investiguese të saj. Interesave të kujt u shërben gazetaria investiguese duke botuar një lajm të caktuar? A e përmbush shtypi përgjegjësinë e vet shoqërore duke zbuluar kundërvajtjet? Interesat e kujt preken? Të drejtat e kujt shkelen? A është çështja në fjalë një çështje me interes publik legjitim? Nëse nuk ka ndonjë çështje publike në rrezik, mos kemi të bëjmë vetëm me shkelje të privatësisë së individit?

Shumica e diskutimeve në lidhje me etikën në gazetarinë investiguese janë përqendruar te metodologjia, ose konkretisht te pyetja nëse ekziston ndonjë metodë e vlefshme për të zbuluar kundërvajtjen. A është legjitim mashtrimi kur kemi parasysh se gazetarët synojnë të tregojnë të vërtetën? A është çdo metodë e përligjur, pavarësisht nga kushtet e punës dhe vështirësitë në marrjen e informacionit? A mund të përdorin kamera të fshehta gazetarët televizivë për të fiksuar rrethanat e një ngjarjeje? A mund të përdorin gazetarët identitete të rreme për të siguruar njohje të informacionit?

Në lidhje me këtë pikë, një faktor i rëndësishëm për t'u marrë parasysh është se publiku është më pak i gatshëm se gazetarët për të pranuar çdo metodë që zbulon kundërvajtjen. Sondazhet tregojnë se publiku shpreh mosmiratim për shkeljen e privatësisë, pavarësisht nga rëndësia e lajmit për publikun. Në përgjithësi, publiku është më pak i prirur të pranojë se gazetarët mund të përdorin çdo metodë për të siguruar lajmin. Një qëndrim i tillë është veçanërisht i dobishëm në rastet kur në shumë vende besueshmëria të shtypi është e ulët. Shtypi duhet të jetë i besue-

shëm në sytë e publikut. Ky është kapitali kryesor i tij, por shumë shpesh veprimet e shtypit e minojnë besueshmërinë e tij. Për pasojë, fakti që qytetarët në përgjithësi besojnë se gazetarët i sigurojnë lajmet me çfarëdo kostoje meriton një shqyrtim të rëndësishëm. Interpretimet që mbështeten në metoda të dyshimta për sigurimin e informacionit mund ta ulin edhe më tej legjitimitetin dhe vlerësimin e publikut për raportimin dhe gazetarët.

Çështjet etike nuk kufizohen vetëm te metodat. Një çështje tjetër e rëndësishme në gazetarinë investiguese është edhe korrupsioni. Korrupsioni përfshin një gamë të gjerë praktikash duke u shtrirë nga gazetarët që pranojnë ryshfete apo fshehin zbulimet, deri tek ata që paguajnë për të siguruar informacion. Duhet shqyrtuar edhe dëmi ndaj qytetarëve privatë që mund të vijë si pasojë e artikujve që botohen. Meqenëse gazetaria investiguese ecën në një vijë shumë të hollë midis së drejtës për privatësi dhe së drejtës së publikut për të ditur, çështjet e privatësisë vetjake zakonisht përbëjnë problemin kryesor. Përgjithësisht presupozohet se privatësia shihet me tjetër sy për figurat publike dhe me tjetër sy për qytetarët e zakonshëm.

Për çështjet e etikës nuk ekzistojnë përgjigje të thjeshta e të gatshme. Pavarësisht nga disa merita që kanë, kodet e etikës nuk ofrojnë zgjidhje të qarta që mund të zbatohen në të gjitha rastet. Shumica e analizëve pajtohen se gazetarët duhet të mbeten të ndjeshëm ndaj çështjeve të tilla si ndershmëria, paanshmëria dhe saktësia. Reporterët duhet të bëjnë vazhdimisht pyetje etike gjatë të gjitha fazave të investigimeve dhe të jenë të gatshëm t'i justifikojnë vendimet e tyre përpara redaktorëve, kolegëve dhe publikut. Ata duhet të jenë të ndjeshëm ndaj faktit se interesat e kujt preken si dhe të operojnë sipas standardeve profesionale.

Raportimi Investigues në Amerikën Latine

Amerika Latine bashkëkohore ofron një gamë të gjerë shembujsh lidhur me faktin se pse i nevojitet demokracisë gazetaria investiguese dhe se si kjo e fundit kontribuon në qeverisjen demokratike. Përgjithësisht, gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit gazetaria investiguese ka fituar forcë në mbarë rajonin. Ndërsa në të kaluarën ajo kufizohej në botime partiake

dhe të dorës së dytë, kohët e fundit është pranuar edhe në shtypin kryesor. Ka shumë arsye që shpjegojnë afirmimin e gazetarisë investiguese, veçanërisht konsolidimi i qeverive demokratike, transformimet thelbësore në ekonominë e mediave, ekzistenca e botimeve të përkushtuara ndaj zbulimit të abuzimeve specifike dhe konfrontimet midis disa mediave të lajmeve dhe disa administratave.

Ashtu si në rajone të tjera të botës, vlera kryesore e gazetarisë investiguese për demokracitë e Amerikës Latine është kontributi i saj në përgjegjshmërinë politike në rritje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme po të kemi parasysh se dobësia e mekanizmave të përgjegjshmërisë është pranuar si një prej problemeve më serioze që po hasin demokracitë në rajon. Letargjia institucionale, mungesa e efektshmërisë dhe mungesa e përgjigjeve ndaj nevojave të ligjshme të publikut shpesh përmenden si dobësitë kryesore. Ekzistenca e mediave të përkushtuara ndaj publikimit investigativ është bërë jashtëzakonisht e rëndësishme. Edhe kur institucione të tjera nuk kanë shprehur interesim për zbulimet e shtypit apo nuk kanë kryer hetimet e tyre, shtypi i ka mbajtur gjallë akuzat për sjellje të jashtëligjshme apo joetike dhe, në disa raste, i ka detyruar organizmat legjislativë e gjyqësorë të veprojnë.

Gazetaria investiguese ka një pushtet të pasqorë për t'i bërë përgjegjës zyrtarët për krime të caktuara, por ajo mund të krijojë edhe një perceptim të gabuar në publik për ekzistencën e kundërvajtjeve. Kjo është thikë me dy presa. Publikimi i kundërvajtjeve e drejton vëmendjen e publikut në krime të pretenduara dhe, kur institucionet që Kushtetuta i ngarkon me hetimin dhe marrjen e vendimeve ligjore ende nuk kanë ndërhyrë, ky publikim mund të çojë edhe në gjykime të nxituara mbi përgjegjësinë e individëve. Pra, theksojmë përsëri se përgjegjshmëria etike ka një rëndësi të jashtëzakonshme: akuzat e pabazuara të shtypit mund të kenë një ndikim të dëmshëm mbi reputacionin e individëve dhe të institucioneve.

Korrupsioni në qeveri ka qenë objekti kryesor i hetimeve të shtypit në demokracitë e Amerikës Latine. Tema të tjera (p.sh. mitëmarrja në korporata apo praktikat e punës së paligjshme) kanë tërhequr shumë më pak vëmendje. Sondazhet e shumta sipas të cilave korrupsioni radhitet vazhdimisht ndër tri shqetësimet më të mëdha në popullsinë e mbarë rajonit flasin qartë për rolin e gazetarisë investiguese në shndërrimin e kundërvajtjeve të qeverisë në një shqetësim madhor.

Rasti i Amerikës Latine tregon se ekzistenca e gazetarisë investiguese është e rëndësishme. Shkalla dhe paanshmëria e praktikës investiguese është gjithashtu e rëndësishme. Shtypi e drejton vëmendjen e qytetarëve dhe të ligjvënësve në çështje specifike. Në demokracitë bashkëkohore, shumë fusha shoqërore dhe qeveritare kanë nevojë për vëmendje. Gazetaria investiguese është më e efektshme kur hedh një dritë të gjerë mbi një numër të madh çështjesh.

Silvio Ueibord është asistent profesor në Departamentin e Gazetarisë dhe të Masmedias në Universitetin Ratgers, Universiteti Shtetëror i Nju Xhërsit.

Udhëtim Nëpër «Fushën e Minuar të Etikës»

Nga Tran Ha

Reporter në Institutin Pointer (Poynter Institute)

Një gazetar investigativ zbulon keqtrajtimin e fëmijëve, por përballet me kritika etike për mosvëprim të shpejtë për të përmirësuar jetën e tyre.

Lajmi: Jeta e fëmijëve me prindër të dhënë pas drogës e alkoolit.

Qëllimi: Duke përdorur përvojat e pak fëmijëve për të treguar edhe historitë e të tjerëve, synohet të përqendrohet vëmendja te një problem mbarëkombëtar.

Dilema: Me publikimin e këtij lajmi, reporteri konstaton se fëmijët janë të shpërfillur, të kequshqyer e të keqtrajtuar.

Si reporter, çfarë do të bënit ju?

Këtë skenar kishin parasysh gazetarët që morën pjesë në një diskutim mbi etikën në Institutin Pointer, një shkollë gazetarie jofitimprurëse. Objekti i studimit ishte «Jetimët e Vesit,» një seri me dy pjesë ku tregohet për fëmijët dhe prindërit e tyre të dhënë pas drogës e alkoolit. Me përshkrimet për fëmijët, këto seri që dolën në gazetën *Los Angeles Times* më shumë se dy vjet më parë, ngritën shqetësime etike në mbarë vendin.

Një shqetësim që lindi nga diskutimi ishte nëse fëmijët qenë lënë në një situatë pa mbrojtje shumë më tepër se ç'duhej.

Reporterja Sonia Nazario, shkrimtare e çështjeve qytetëse në gazetën *Times*, harxhoi pesë muaj duke publikuar mbi fëmijët dhe dy muaj për shkrimin e historisë. Ç'mund të ishte bërë gjatë kësaj kohe për të minimizuar dëmin ndaj këtyre fëmijëve?

Terens Oliver, drejtor artistik në gazetën *Akron Beacon Journal*, tha se sipas mendimit të tij Nazario nuk kishte pse të harxhonte pesë muaj duke publikuar mbi fëmijët.

«Mendoj se pesha e problemit dukej qartë,» tha Oliver. «Vetë tema ishte e fuqishme. Sa energji duhej t'i kushtohet?»

Oliver, i cili kishte adoptuar një fëmijë në një situatë të ngjashme me atë të historisë, ka njohuri të dorës së parë mbi plagët fizike dhe emocionale që rrjedhin nga neglizhimi e keqtrajtimi.

Gazetarë të tjerë e mbështetën shqetësimin e Oliverit në lidhje me sasinë e kohës që ishte dashur që të botohej historia.

«Dukej që ishte një produkt i mrekullueshëm gazetarie,» tha Majk Uendland, Bashkëpunëtor në Pointer, «por është e papranueshme të harxhosh kaq shumë kohë për atë sasi pune.»

Më pas Nazario tha se sasia e kohës së harxhuar për t'i shkruar seritë ishte «një prej kritikave më të përligjura që m'u bënë. Tani them se nëse ke ndërmend të shkruash diçka të tillë, është mirë që ta bësh shumë më shpejt.»

Për Lori Nikolskin, ndihmësredaktor në *The Journal News* në Uajt Pleins të Nju Jorkut, mësimi më i madh që u nxor nga diskutimi ishte rëndësia e vendimmarrjes etike nga fillimi në fund.

«Gazeta duhej dhe mund të kishte qenë e përgatitur më mirë për reagimin që do të bëhej,» tha Nikolski. «Ndjeva se gjatë kësaj historie reporterja ishte lënë

pa përkrahje. Mendoj se redaktorët duhej t'i kishin dhënë më shumë mbështetje që në fillim.»

Nazario tha se është dakord dhe mendon se në përgjithësi në studiot e lajmeve nuk para ka diskutim mbi etikën mes reporterëve dhe redaktorëve.

«Më duket se as redaktorët dhe as reporterët nuk e ngrenë shpesh këtë çështje,» tha ajo. «Sikur historinë ta kisha diskutuar më shumë që në fillim, mund të ishin kursyer ca kritika. Jo se do të ishin kursyer të gjitha, por disa.»

Gjëja më e rëndësishme që duhet të fiksojmë në mendje është se ashtu siç arriti t'i gjente Nazario këta fëmijë, po ashtu duhej t'i gjenin edhe shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve, tha Tena Ezadin, një reportere investiguese për WBNS-TV në Këlambës, Ohajo.

«Histori si kjo – që e nxjerrin shoqërinë zbuluar në formën më të rrallë – duhen treguar,» tha Ezadin. «Mendoj se gjëja më e keqe që mund të bëjmë ne si gazetarë është që t'i largohemi historive si kjo nga frika e publicitetit negativ.»

«Është e pamundur të trajtosh disa prej këtyre historive pa shkaktuar kurrfarë dëmi,» tha Nazario. «Çështja është se deri në ç'shikallë vëzhgon, si e balancojnë këtë me të treguarit e asaj që po ndodh dhe ç'e mirë mund të vijë duke treguar atë që po ndodh.»

Kjo na kujton se ka edhe raste kur gazetaria e mirë nuk e mbyll punën me një fund të rregullt e të rehatshëm, tha Al Tompkins, udhëheqës i grupit të medias elektronike në Institutin Pointer. Një pjesë e fuqisë së kësaj historie qëndron në faktin se ajo nuk u zgjidh ashtu si duhet, tha ai.

«Në fund kuptova se kishim të bënim me një produkt të fuqishëm gazetarie dhe se kjo gazetarë i bëri shërbim si temës, ashtu edhe njerëzve të implikuar dhe publikut,» tha Nikolski. «Shumë shpesh mendoj se kur merresh me çështjet e fëmijëve, një fëmijë i caktuar ose humbet, ose përdoret sa për të justifikuar problemin. Sonia i solli fëmijët në jetë.»

Leja që mbulon ribotimin, përkthimin dhe përdorimin në Internet është marrë. E drejta e autorit © i takon The Poynter Institute, një qendër trajnimi gazetarie jofitimprurëse.

Ç'Janë Qentë Roje të Medias

Nga Virxhinia Uajthauz
Asistent Professore e Studimeve të Komunikimit
Kolegji Uituërth, Spokejn, Uashington

Grupet vigjëluese që mbikëqyrin vendimet dhe praktikat etike të gazetarëve dhe të agjencive të medias shpesh nxiten nga vlera dhe agjenda vetjake, të cilat duhen vlerësuar për të kuptuar kritikën e tyre.

Hyrje

Roli i gazetarisë në demokracinë amerikane është zhvilluar duke përfshirë brenda saj edhe funksionin e një kontrolli të qeverisë në kuptimin që gazetaret presupozohen se do të kryejnë hulumtime nëse zyrtarët e zgjedhur abuzojnë me të drejtat dhe liritë e njerëzve të zakonshëm.

«Për gazetaret është shumë e qartë që raportimi investigues informon publikun, ekspozon korrupsionin dhe ndreq kundërvajtjet,» tha Xhein E. Kirtli, profesore dhe e etikës dhe e ligjit të medias në Universitetin e Minesotës, në një artikull të botuar tetorin e kaluar në *Columbia Journalism Review*.

Megjithatë, është diçka e njohur që gazetaret amerikanë vihen në shënjestër ngaqë e bëjnë punën e tyre në një mënyrë të tillë që sjell më shumë dëm, sesa përfitim. Nëse gazetaret duhet të jenë qen roje, atëherë kush e ruan qenin roje? Ka shumë vullnetarë për të bërë punën e qenve roje të medias; megjithatë, motivimet dhe njëanshmëritë e këtyre qenve roje duhen të vlerësohen për të kuptuar e analizuar kritikën e tyre.

Liria e shtypit në Shtetet e Bashkuara i takon personit që është pronar i shtypit (ose i stacionit televiziv, revistës apo buletinit). Disa media kombëtare, përfshirë gazetën, rrjetet kabllore dhe transmetuesit e laj-

meve, priren për ta bërë objektivitetin apo ndershmërinë vlerën më parësore të lajmeve, sepse pikërisht këtë presin auditorët e tyre. Revistat, buletinet dhe mediat e tjera mund të kenë vlera të ndryshme në lajme, si p.sh. mbështetja e një ideje, të drejtat e njeriut apo vlerat e familjes, promovimi i një industrie si moda apo makinat, etj. Pronari i medias vendos se ku do të konsistojë vlera e lajmeve.

Edhe ata që e kritikojnë median kanë vlerat dhe agjendat e tyre. Njohja e vlerave të kritikëve e ndihmon lexuesin të kuptojë këndvështrimet, interpretimet, madje edhe «nuancën» (në kuptimin e interpretimit) që përdorin kritikët për të analizuar median. Disa prej kritikëve më të ashpër mund të jenë ata brenda profesionit, të cilët mund të kenë më shumë dijeni për vendimet dhe praktikën etike të kolegëve të tyre, por edhe ata i bazojnë kritikën e tyre në vlerat e reflektuara në industrinë e lajmeve.

Grupet e Qenve Roje Jashtë Industrisë

Titujt e artikujve dhe deklaratat e misioneve mund të japin një ide në lidhje me agjendën politike të një grupi vigjëlues të medias edhe nëse emri i grupit mund të duket si ai i një vëzhguesi të paanshëm. Për shembull, emri i Qendrës Kërkimore të Medias (Media Research Center [MRC]) [<http://www.media-research.org/>], me qendër në Nju Jork, tingëllon si asnjë, por MRC e shpjegon qartë në deklaratën e misionit të vet se nuk është asnjë. Seksioni i lajmeve i MRC raporton se qysh prej vitit 1987 kjo qendër ka «punuar për të vendosur një balancë politike në mediat e lajmeve të vendit duke dokumentuar dhe duke dalë kundër njëanshmërive liberale të lajmeve të rrjeteve televizive dhe të botimeve kryesore të shtypit.» MRC thotë se është «or-

ganizata konservatore vigjëluese e medias më e madhe dhe më e respektuar e vendit.» Komentuesit e MRC dalin rregullisht në programet e lajmeve të rrjeteve dhe të stacioneve kabllore për të kritikuar median dhe qëndrimet e tyre janë në favor të agjendave konservatore. Titujt më të fundit përfshijnë: «20 Vjet Qëndrime Liberale nga Gunga Dan» dhe «Llafazanët Flasin Gjepura Mbi Uljen e Taksave.» [http://www.mediaresearch.org/news/reality/2001/Faxrep.html]

Grupe të tjera vigjëluese i përqendrojnë kritikën në pasurinë dhe ndikimin në rritje të konglomerateve korporative. Edhe emrat e tyre tingëllojnë asnjans, por agjendat i kanë të deklaruara qartë. Në deklaratën e misionit të saj, Media Channel [http://www.mediachannel.org/] raporton: «Më shumë se kurrë më parë jetojmë në një epokë të medias dhe në një botë të medias. Media botërore mbisundohet nga nëntë konglomerate ndërkombëtare; marrëveshjet prej shumë miliardë dollarësh po e përqendrojnë pushtetin edhe më tej. Megjithatë, ne po përjetojmë edhe revolucionin teknologjik... Vitaliteti i komunikimit tonë politik e kulturor mbështetet në një media të lirë e të shumëllojshme që i ofron hyrje të lirë kujtdo.»

FAIR (Fairness and Accuracy in Reporting) (Ndershmëri dhe Saktësi në Raportim) [http://www.fair.org/index.html] kërkon fakte për ushtrim censure nga pronarët e korporatave, për njëanshmëri të përgjithshme korporative dhe për mungesë diversiteti në pasqyrimin e lajmeve. Në një artikull të muajit mars nga FAIR [http://www.fair.org/activism/aids-africa-abc.html] argumentohet se programi *World News Tonight* i stacionit ABC, në një lajm mbi patentat për medikamentet e SIDA-s në Afrikë, jepte vetëm këndvështrimet dhe interpretimet e kompanive farmaceutike dhe të mbështetësve të tyre.

Informacioni i paraqitur nga këto lloje grupesh vigjëluese si dhe analiza që ofrohet mund të jenë të dobishme për të interpretuar pasqyrimin në media, por lexuesit duhet të jenë në dijeni të supozimeve të pashprehura dhe të njëanshmërive në përzgjedhjen e lajmeve dhe në kritika.

Kritikat nga Brenda Industrisë së Medias

Analizat për gazetarinë veprojnë si qen roje të medias brenda industrisë së medias. Këto analiza shkruhen kryesisht nga profesionistë të medias për profesionistë të medias, përgatiten në universitete dhe nuk pretendojnë të kenë një qëndrim të caktuar në lidhje me lajmet apo një agjendë specifike për transformimin e tyre. Redaktori Ekzekutiv Majk Hojt beson se botimi i tij, *Columbia Journalism Review (CJR)* [http://www.cjr.org/], i ndihmon gazetarët për ta bërë më mirë një punë të vështirë.

«Në këtë vend shtypi është oksigjeni i demokracisë,» tha Hojt në një intervistë. «Në shkallën që është vigjilent shtypi, në atë shkallë funksionon edhe shoqëria. Punën tonë ne e shohim si nxitje e frymëzimit për shtypin në mënyrë që ai ta bëjë mirë punën e rëndësishme që ka.»

Gjatë vitit të kaluar, *CJR* ka hulumtuar e raportuar mbi vëllimin e lajmeve kombëtare të prodhuara në Nju Jork Siti duke i dhënë vendit një këndvështrim shumë njujorkez; po ashtu mbi përdorimin e lobistëve nga krerët e mediave korporative për të ushtruar influencë në Uashington, D.C.; si dhe mbi mënyrën se si po ndikojnë juristët në vendimet redaksionale.

Në vitin 1961, kur Shkolla Pasuniversitare e Gazetarisë e Universitetit të Kolumbias themeloi *CJR*, kjo ishte gazeta e vetme kombëtare kritike e medias e llojit të vet. Aktualisht ekzistojnë edhe analizues të tjerë kombëtarë, përfshirë *American Journalism Review* [http://ajr.newsling.org/], botuar nga Fondacioni i Universitetit Merilend, si dhe botime lokale, të tilla si *St. Louis Journalism Review* [http://www.webster.edu/~review/], e cila para pak kohësh festoi 30-vjetorin e saj në Universitetin Webster.

Këta komentues ofrojnë një këndvështrim dhe interpretim të brendshëm që pasqyron vlerat e industrisë bazë të shtypit – mbrojtjen nga Amendamenti i Parë, vërtetësinë dhe saktësinë si dhe pasqyrimin e balancuar. Hojt thotë se ka më shumë të ngjarë që profesionistët e medias në Shtetet e Bashkuara t'i marrin më seriozisht kritikën që u bën një analizë e gazetarisë, sesa kritikën nga qentë roje të medias me agjenda politike, sepse analiza ofron këndvështrimin

e një «të jashtmi» nga të brenshmit e industrisë së medias.

«Është shumë e lehtë t'i kritikosh njerëzit. Ne duam të jemi të ashpër, por duam të kuptojmë edhe pozitën e gazetarit,» tha Hojt. «Ka shumë kritika. Nëse ato nuk janë shkruar mirë dhe nëse nuk bëhen nga një prej të tuve, ekziston prirja për ta bërë veshin shurdh ndaj tyre.»

Kritikat nga Këshillat e Lajmeve

Shumë gazetarë dhe organizata gazetarësh janë përpjekur, ose të paktën e kanë shqyrtuar gjallërisht, mundësinë për të ngritur këshillat e lajmeve për të arbitruar mosmarrëveshjet mes gazetarëve dhe njerëzve për të cilët shkruajnë. Këshilli Kombëtar i Lajmeve, i modeluar sipas homologut të vet anglez, Këshilli Britanik të Lajmeve, jetoj pak më shumë se një dhjetëvjeçar duke u mbyllur në vitin 1984. Megjithatë, Këshilli i Lajmeve i Minesotës [http://www.mtn.org/~newscncl/], vazhdon ta mbajë me sukses një forum të tillë që nga viti 1971. Për trajtimin e mosmarrëveshjeve, anëtarët e këshillit përpiqen të mbledhin për diskutim së pari menaxherët e lajmeve dhe ata që besojnë se janë dëmtuar nga artikujt. Shpesh, një gjë e tillë e zgjidh konfliktin. Më pak se 8 përqind e atyre që paraqesin ankesa kërkojnë në fund një interpelancë përpara këshillit 12-anëtarësh të përbërë nga gjashtë gazetarë dhe nga gjashtë qytetarë të zakonshëm.

Këshilli i Lajmeve të Minesotës ka nxjerrë më shumë se 100 vendime gjatë historisë e vet, gjë që thjesht do të thotë se këshilli ka deklaruar publikisht nëse gazetari apo organizata e lajmeve kishte vepruar apo jo në mënyrë etike në çështjen në fjalë. Këshilli i Lajmeve nuk ka më shumë pushtet se kaq.

«Kemi vënë re se kur anëtarët e publikut kalojnë nëpër procesin tonë, respekti i tyre për median e lajmeve është më i madh në fund se në fillim,» shkruan Bob Sho, një anëtar themelues, në faqen e Internetit të Këshillit të Minesotës. «Ata po e shohin se këshilli ynë, i përbërë barabar nga anëtarë të medias dhe të publikut, nuk është ndonjë truk i hollë për marrëdhëniet publike, por një ushtrim në ndershmërinë themelore.»

Por ekzistenca e këshillave të lajmeve në vetvete nxit edhe polemika. Disa besojnë se formimi i këshillave të tilla kërcënon liritë e Amendamentit të Parë duke centralizuar standardet gazetareske, ndërsa të tjerë duan t'i shmangen interpretimit të motiveve të kolegëve të tyre. Stacioni KSTP-TV i Mineapolisit dhe kompania e tij mëmë Hubbard Broadcasting nuk kanë marrë pjesë kurrë në këshill.

«Nëse dikush ndien se ne e kemi shkelur, ai mund të flasë ose drejtpërdrejt me ne, ose t'i drejtohet gjykatës,» i tha Stenli Habërd, drejtor ekzekutiv, gazetës *Minneapolis Star Tribune* në vitin 1996. «Unë nuk dua të ndodhem në një situatë ku një panel njerëzish ulen për të dhënë gjykime mbi gjykimet tona.»

Edhe këshilla të tjera janë kritikuar në mënyrë të ngjashme. Këshilli i Lajmeve me qendër në Siatëll, shteti Uashington, i ngritur përpara dy vjetësh, është akuzuar se nuk është gjë tjetër veçse një tufë ngatërruar të vetëmëruar që në fakt qëndrojnë në krah të kritikëve të medias. Ky këshill u kritikua ashpër edhe për atë që financimet e veta të para i mori nga Fondacioni Bill dhe Melinda Gejts, një organizatë bamirëse e drejtuar nga themeluesi i kompanisë Microsoft dhe bashkëshortja e tij, duke rrezikuar kështu krijimin e një konflikti të mundshëm interesi si dhe një dilemë etike brenda një grupi të ndërtuar për të trajtuar etikën e medias.

Pavarësisht nga këto shqetësime, këshillat e lajmeve ofrojnë një shans shumë të nevojshëm që publiku të ndërveprojë me median dhe të ofrojë kritikën e vet për të, tha në një artikull në *Columbia Journalism Review* shkurtin e kaluar Geneva Overholser, ish-avokate e gazetës *Washington Post*, aktualisht pedagoge në Universitetin e Misurit. «Ne nuk mund të lejojmë të na ikë asnjë shans i arsyeshëm për të dhënë llogari për veten tonë dhe për të ndihmuar publikun të kuptojë gjithçka që bëjmë ne për të mbrojtur parimet tona dhe për t'i vënë në vijë punët,» tha Overholser.

Kritikat nga Organizatat Profesionale

Organizatrat profesionale i ndihmojnë gazetarët të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të luftojnë në bazë të ligjit kur kërcënohen të drejtat e tyre sipas Amendamentit të Parë. Shoqata e Drejtorëve të Lajmeve të

Radiove dhe Televizioneve përshëndeti publikisht vendimin e Gjykatës së Apelit të SHBA për të lejuar transmetimin e drejtpërdrejtë të argumenteve gojore në çështjen gjyqësore të Shteteve të Bashkuara kundër Microsoftit [<http://www.rtnda.org/news/2001/microsoft.shtml>]. Zyrtarë të Shoqërisë së Gazetarëve Profesionistë (SPJ) dalin rregullisht kundër ndërhyrjes së qeverisë në punën e përditshme të gazetarëve. Vlera që këto organizata i japin lirisë gazetareske qëndron në kritikën, lëvdatat, madje edhe në mbështetjen financiare që ofrojnë.

Të njëjtat organizata mund të krijojnë edhe kode etikash që ndihmojnë në praktikën profesionale të gazetarëve. Kur gazetarët shkelin kodet, organizatat mund të deklarojnë kundërshtimin e tyre për shkeljen. Komiteti i Etikës i SPJ akuzoi stacionet Fox, ABC, CBS, NBC, CNN si dhe Associated Press për shkeljen e Kodit të SPJ [<http://www.spj.org/ethics/code.htm>] duke «mos vepruar në mënyrë të pavarur.» Të gjitha këto agjenci të mëdha lajmesh kishin bërë kontrata me Shërbimin e Lajmeve të Votuesve për rezultatet e zgjedhjeve presidenciale të nëntorit dhe pastaj ishin mbështetur në raportin e pasaktë të këtij shërbimi sikur Zëvendëspresidenti Al Gore kishte fituar votat elektorale të Floridës [http://www.spj.org/news/112100_pressrelease.htm]. Kjo kritikë mbështetet në supozimin se organizatat e lajmeve duhet të kërkojnë dhe të verifikojnë në mënyrë autonome informacionin në vend që të mbështeten te shërbimet me kontrata. Vlera e të vepruarit në mënyrë të pavarur krijon themelin për të sfiduar gjykimet e gazetarëve në lidhje me lajmet.

Megjithatë, hetimet e drejtpërdrejta dhe dënimet për raportime të mangëta nga organizatat brenda industrisë së shtypit janë të rralla. «Nëse kjo (praktikë e dobët profesionale) do të ndodhte në ndonjë profesion tjetër apo qendër pushteti në jetën amerikane, media do ta bënte tërkuzë lajmin duke e mbajtur dritën të përqëndruar mbi institucionin kundërvajtës,» shkruante gazetari Sidni H. Shanberg, fitues i Çmimit Pulitzer, në një kryeartikull të gazetës *Washington Post* në vitin 1999. «Kur firmat juridike shkelin kanunet etike, kur agjentët e Uoll Stritit mashτροjnë klientët, kur kompanitë shëndetësore u mohojnë kujdesin jetik pacientëve, ne gazetarët i konsiderojmë lajme dhe shpesh i vendosim në faqen e parë. Po kur kundërvajtësi është vetë profesioni ynë, atëherë tkurremi.»

«Asnjë gazetë nuk ka qejf të pranojë mangësitë e veta apo të ekspozojë ato të homologëve (të cilët mund t'ia kthejnë nderin). Të gjithë kanë të brendshme të palara,» shtoi Shanberg.

Ndërkohë, sipas studimeve të Shoqërisë Amerikane të Redaktorëve të Gazetave [<http://www.asne.org/kiosk/reports/99reports/1999examiningourcredibility/>], publiku amerikan beson se media nuk është kritike sa duhet ndaj vetes dhe nuk demonstroi në mënyrë të vazhdueshme respekt për komunitetet që pretendon se u shërben.

Në përgjigje të kësaj pune kërkimore, grupi i Redaktorëve Përgjegjës të Associated Press (APME) ka përdorur një metodë tjetër për nxitjen e kritikave, metodë që konsiston në sjelljen e lexuesve dhe të atyre që janë prekur drejtpërdrejt nga lajmet në tryeza diskutimesh me redaktorët dhe botuesit e gazetave lokale. Me mbështetjen e Fondacionit Ford, sesionet e sponsorizuara nga APME shqyrtojnë besueshmërinë gazetareske në studiot e lajmeve në të 50 shtetet, tha Kerol Nanelli, Redaktore Përgjegjëse dhe Koordinatorë Projekti të gazetës *Birmingham News*. Këto forume lejojnë që të sillen brenda studiove të lajmeve kritikën nga jashtë.

Në Janar 2001, gazeta *Spokesman Review* në Spokane të Uashingtonit mbajti tryezën e saj të parë të rrumbullakët. Anëtarë të këshillit të qytetit, firma ndërtimi të pasurive të patundshme, akademikë dhe aktivistë të komunitetit zhvilluan një diskutim dyorësh me redaktorët dhe gazetarët e gazetës. U shqyrtuan konfliktet e mundshme të interesave për botuesin e gazetës, familja e të cilit kishte ngritur një kompleks dyqanesh në qendër të qytetit dhe një garazh parkimi që kishin shkaktuar mosmarrëveshje.

«Ky (dialog) i lejoj njerëzit e interesuar të mblidhen me gazetarët e vërtetë pa ndonjë filtër në mes,» tha Kris Pek, president i APME dhe redaktor i *Spokesman Review*. «Të dyja palëve iu kërkua që të ishin më të ndershëm. Njerëzit nuk bërtitën e nuk pati shpërthime. Nëse dikush kishte mosbesim tek media apo ishte arrogant me median, dikush tjetër do të ndalej tek ai.»

Përfundim

Korrespondenti në pension i Washington Post, Murrei Marder, deklaroi në Konferencën Nieman për Gazetarinë Vigjëluese në vitin 1998: «Frika nga abuzimi me pushtetin ka qenë forca elektrizuese në Revolucionin Amerikan dhe vazhdon të jetë justifikimi më i fortë për një shtyp sfidues dhe tërësisht të pavarur.» Megjithatë, në të njëjtin fjalim, Marder tha se amerikanët nuk e besojnë median e tyre, sepse media është tepër enigmatike mbi mënyrën e funksionimit të gazetarisë. Ka një tension midis këtyre ndryshoreve: nxitja e shtypit vigjëlues, nxitja e kritikave për shtypin pa e mbytur atë si dhe ruajtja e lirive për shtypin dhe kritikët e tij.

Disa besojnë se roli i qenit roje përmbushet më mirë nga grupet e jashtme, edhe nëse këto grupe kanë agjendat e tyre vetjake. Të tjerë besojnë se ata që janë brenda industrisë së medias janë më të pajisur për të bërë kritika, veçanërisht ngaqë ka më shumë gjasa që të respektohen nga gazetarët. Megjithatë, në një mënyrë apo në një tjetër, të gjithë këta qen roje kontribuojnë në bashkëbisedimin e vazhduar se çfarë do të thotë të kesh shtyp të lirë në një shoqëri të lirë.

Virxhinia Uajthauz, Doktore në Filozofi (Ph.D.), është Asistent Profesore e studimeve të komunikimit në Kolegjin Uituërth në Spokejn të Uashingtonit. Është gjithashtu zëvendëskryetare e Seksionit të Etikës së Medias të Shoqatës për Edukimin në Gazetari dhe Komunikimin Masiv si dhe ish-kryetare e Komitetit Kombëtar të Edukimit të Gazetarisë të Shoqërisë së Gazetarëve Profesionistë.

Gazetaria në Epokën e Internetit

Nga Bob Gails

Botues i «Nieman Reports»

Fondacioni Nieman për Gazetarinë

Universiteti i Harvardit

Gazetaria në Internet është energjike dhe luftarake, por stili i saj dhe cikli i lajmeve për 24 orë ngre pikëpyetje në lidhje me mënyrën se si gazetaria elektronike mund të ofrojë pasqyrim në përputhje me standartet më të larta të gazetarisë.

Organizatrat tradicionale të lajmeve po luftojnë për të zbatuar standartet e modës së vjetër për lajmet në Internet, por po zbulojnë se nuk është e lehtë që virtetet e saktësisë, paanshmërisë dhe qartësisë të mishërohen në një medium ku mbizotërojnë avantazhet e shpejtësisë dhe të momentit oportun të raportimit.

Teknologjia e Internetit i ka forcuar funksionet tradicionale të gazetarisë si qen roje duke u dhënë gazetarëve rrugë të efektshme për të kërkuar më thellë për informacion. Kapaciteti i saj për të kërkuar dokumente, për të përpiluar kontekste rrethanash dhe historike si dhe për të identifikuar burime të autoritetshme e ka zgjeruar çantën e veglave të gazetarit. Ajo ka vënë në përdorim edhe një kulturë thelbësisht të ndryshme të ndërtuar mbi ndërveprueshmërinë, me më pak rregulla dhe me më pak kufij.

Shpejtësia dhe momenti oportun kanë qenë dikur pika e fortë e gazetave. Agjencitë e lajmeve e ndërtuan reputacionin e tyre duke qenë të parat për lajmet e mëdha, të cilat njerëzit zakonisht i gjenin nëpër gazetatat lokale. Menjëhershmeria e televizionit ia mori këtë avantazh shtypit të shkruar. Tani edhe Interneti i ka ndërtuar avantazhet e veta të shpejtësisë e të momentit oportun dhe duke bërë këtë, u ka dhënë mundësi gazetave të kryejnë ciklin e plotë duke afishuar lajme të çastit dhe duke zgjeruar identitetet e tyre përmes risive të tilla si emisionet elektronike të pasdites.

Në pikëtakimin e gazetarisë tradicionale dhe Internetit, përpjekjet për të zbatuar standartet e studios tradicionale të lajmeve hasin në vlera të tjera të tilla si liria, mungesa e respektit, avokatia dhe qëndrimet. Gazetarët e Internetit argumentojnë se tonet olimprike të shtypit tradicional nuk funksionojnë në shtypin elektronik. Ata e përqasin mediumin e tyre të ri me shpirtin e vërtetë të Amendamentit të Parë të Kushtetutës së SHBA që siguron lirinë e fjalës, të shtypit dhe të grumbullimit. Shkruesit e shtypit elektronik vërejnë se mediumi i tyre i ri evokon kohën kur gazetaret ishin energjike dhe luftarake. Ana Kompton e ABCNews.com e përshkruan kështu dallimin midis stafit të saj të shtypit elektronik në Internet dhe gazetarëve të rrjetit televiziv: «Ne shkruajmë më energjikisht. Përdorim më shumë stil bisedor. Në raportimet e shtypit me «pikë-kom» ka një pasuri që nuk mund ta përdorësh në televizion.» Krahasime të ngjashme mund të bëhen edhe midis Internetit dhe gazetave të përditshme.

A është një «pasuri» e tillë në përputhje me standartet më të larta të gazetarisë? A mund të përshtatet natyra e çlirët, nxitëse dhe e guximshme e Internetit me një kulturë, traditat e së cilës janë formuar nga një media më e përmbajtur dhe më e strukturuar?

I ndikuar nga tri zhvillime, procesi i vendosjes së standardeve në shtypin elektronik po ecën përpara. I pari është realiteti që faqet mbizotëruese të lajmeve në Internet drejtohen nga media e vjetër – nga organizatat tradicionale të lajmeve si gazetatat e përditshme, revistat e lajmeve dhe rrjetet e stacioneve televizive apo ato kryesore kabllore. Ajo që e bën këtë një realitet është ndikimi i tregut, i cili ka qenë veçanërisht i ashpër ndaj kompanive «pikë-kom» të reja. Si ato me kapital të pamjaftueshëm apo me famë gazetareske dytësore, edhe ato me strategji të dobë-

ta marketimi, po shuhen. Mes të mbijetuarve janë organizatat kryesore të lajmeve që kanë burime për të ndërtuar faqe të fuqishme Interneti dhe për të bërë të mundur që këto platforma të pasqyrojnë standardet rigorozë sipas të cilave shkruhen dhe redaktohen botimet e tyre në shtyp.

Zhvillimi i dytë ka të bëjë me përpjekjet e gazetarëve të shtypit elektronik për të krijuar standarde për Internetin. Shoqata e Lajmeve të Shtypit Elektronik po fillon një projekt për të hartuar udhëzime të efektshme, përfshirë edhe rekomandimet për zbatimin dhe monitorimin e tyre. Një donacion nga Fondacioni Xhon S. dhe Xheims L. Najt do t'i japë mundësi Shoqatës së Lajmeve të Shtypit Elektronik për të punësuar një drejtor projekti dhe për të respektuar afatin Tetor 2001 për udhëzimet që rekomandon.

Riç Jaroslovski, president i Shoqatës së Lajmeve të Shtypit Elektronik dhe redaktor përgjegjës i *Wall Street Journal Interactive* thotë se «Nevoja për projektin është e ngutshme. Në vend që të ekzistojë një arsye për vendimet, shumë vendime në lidhje me lajmet në shtypin elektronik po merren thjesht me intuitë,» vazhdon ai. «Shpresojmë të hartojmë një dokument që nuk drejton, por detyron,» jo vetëm gazetarët, por edhe ata që punojnë në kultura të tjera në Internet dhe që i dallojnë mirë lajmet nga tregtia.

I treti, ndoshta ndikimi më me qitje të largët mbi standardet gazetareske, është ndërveprueshmëria që rezulton kur gazetarët afishojnë adresat e tyre të postës elektronike (e-mail) në Internet. Posta elektronike mund të ofrojë reagime të menjëhershme për një artikull që sapo është afishuar në Internet apo që është botuar në një gazetë që lexohet kur pihet kafeja e mëngjesit. Disa reporterë po i krijojnë pengesa një angazhimi të tillë me lexuesit duke parapëlqyer që ose të mos kenë postë elektronike, ose të rrinë pas një filtri që lejon të kalojnë vetëm ato mesazhe që mendojnë se u duhen.

Posta elektronike u jep mundësi reporterëve dhe redaktorëve që të marrin të dhëna prej njerëzve që mund të dinë diçka rreth një ngjarjeje të botuar, mund t'u sugjerojnë mendime të besueshme, t'u ofrojnë burime të tjera, apo të ngrenë pikëpyetjen se artikulli mund të jetë i paanshëm apo i padrejtë. Një ndërveprueshmëri e tillë ka gjasa të shumta të kontribuojë në rritjen e nivelit të punës në gazetari.

Xhon Kac, komentues në Internet dhe që shkruan për Slashdot.com, thotë: «Ajo që më habit është shkalla e lartë e kërkimit të llogarisë prej lexuesve. Çfarëdo që të shkruash, artikulli yt e çan rrugën e vet deri tek njerëzit më të informuar mbi temën Ajo që mëson është se artikulli yt nuk është fjala e fundit, por është fjala e parë.»

Leja që mbulon ribotimin, përkthimin dhe përdorimin në Internet është marrë. Ribotuar me lejen e Nieman Reports.

Lajmet në Epokën e Parasë

Nga Diana B. Henrikes
Gazetare Ekonomike për *The New York Times*

Që në fillim të viteve 1980, ekonomia e SHBA filloi të rritej në harmoni me tregjet duke krijuar vende pune e pasuri. Autorja shqyrton se në ç'shka-llë e kanë pasqyruar gazetarët këtë epokë parash dhe si i kanë trajtuar ata tundimet e vjetra sa bota.

Në vitet 1980 punoja në Nju Xhërsi si gazetare investiguese në *Trenton Times* duke u përpjekur të zhburoja pikëpamjet lokale për mashtrimin e çuditshëm «Abscam» të FBI-së kur anëtarë të Kongresit filmoheshin fshehurazi duke pranuar rryshfete nga agjentë sekretë që hiqeshin si ndihmës të një sheiku arab. Nga fundi i vitit 1982 isha reportere biznesi dhe mbuloja krizën e borxhit latino-amerikan për gazetën *The Philadelphia Inquirer*. Vëzhguesi i medias Din Rotbart thotë se në vitin 1980 kishte vetëm disa mijëra gazetarë biznesi. Në vitin 1988, kur buletini i tij *TJFR Business News Reporter* i numëroi këta për herë të parë, në tregjet e pesëdhjetë gazetave kryesore dhe në botimet kombëtare mbi biznesin në Shtetet e Bashkuara ishin rreth 4.200 vetë si puna jonë.

Duke qenë se ishim mësuar vetëm me ritmin e lajmeve politike, ne u gjetëm tërësisht të papërgatitur për të pasqyruar trashëgiminë ekonomike të viteve 1970. Përpara se të kishim mësuar përmendsh të gjithë anëtarët e OPEK-ut, u ndodhëm përballë një «luftë» tjetër – fushatës së Kryetarit të Rezervës Federale Pol Volker për të ulur inflacionin. Kjo kërkonte diçka të re: një fjalor të përshtatshëm për të shpjeguar mospërputhjen e skajshme midis kurseve të huamarrjes e të huadhënies në banka dhe kursimeve e huave (K&H), të kuptuarit e marrëdhënieve midis riskut dhe shpërblimit prej tij si dhe të paktën një ide elementare se kush i rregullonte bankat, K&H-

të, fondet e tregjeve të parave si dhe të ardhurat nga sigurimet. Për t'i rënë shkurt, u ndodhëm në një moment vërtet të vështirë.

Ana e ndritshme e këtij udhëtimi të dalldisur të tipit «mëso duke bërë» ishte se çdo ditë pune na sillte një shans të ri për t'u ndier më të lirshëm dhe për të zgjeruar njohuritë. Një nga pasojat më pak të këndshme të odisesë sonë ishte ngjitja jonë e pandalur në bregun e pjerrët të kurbës së të mësuarit. Injoranca jonë e mëparshme na bënte skeptikë dhe na e vështirësonte mundësinë për analiza të pavarura. Dhe përpara se të arrinim të prodhohim artikuj të qartë e tërësisht të informuar, të cilët janë fryt i kulmit në kurbën e të mësuarit, shumë shpesh e gjenim veten sërish në tokë të panjohur.

Mbi të gjitha, teknologjia po e shkund varkën nga e cila po mundohemi ta pasqyrojmë. Shumë prej nesh nuk jemi më thjesht gazetarë, por «dhënës të përmbajtjes së multimedias.» Në vitin 1980, të kërkoje nëpër arkiva do të thoshte të shfletojë nëpër zarfa të mbushur me prerje gazetash mjaft të brishta; sot, gjithkush i gjen artikujt e botuar duke klikuar dy herë. Në atë kohë, e vetmja mënyrë për t'i dorëzuar një artikull studios së lajmeve nga diku jashtë saj ishte t'ia diktoje atë një personi nga një telefon publik. Sot unë ia diktoj artikujt programit që e shkruan tekstin vetë duke folur unë, të cilin e kam në kompjuterin tim portativ, dhe e dorëzoj me e-mail duke kontrolluar më pas me telefonin tim celular se mos zyra e kopjeve ka ndonjë pyetje.

Në ditët e mira besoj se ky lulëzim i mrekullueshëm njëzetvjeçar në lajmet e biznesit ka prodhuar një korpus të shtypit financiar me thellësi e gjerësi të paparë dhe se teknologjia e ditëve të sotme thjesht na jep fuqinë për të bërë më shumë, më mirë e më

shpejt. Por nëse më të mirët e më të shkëlqyerit e sotëm janë bërë mjeshtra në makinerinë moderne të gazetarisë së biznesit, ata duken shumë më naivë në lidhje me tundimet e tij të vjetra sa bota. Ata që mbulojnë «ekonominë e re» për «median e re» duket se nuk e kuptojnë fare se pse qenka problem i madh që të investojnë drejtpërdrejt në industrinë që mbulojnë, të pranojnë aksione të lira nga brenda në ofertat fillestare publike të ndonjë miku në industri, apo të bëjnë punë konsulente mënjanë për kompanitë e teknologjisë.

Në një artikull të thellë në *Salon* në mesin e vitit 1999, Xhanel Braun sugjeronte se neve na nevojiten rregulla të freskëta etike «mjaft elastike për të parashikuar çështje të reja që me siguri do të dalin në këtë industri që ecën me ritme të shpejta, ku jeta e gazetarëve është gjithnjë e më e lidhur si me njerëzit për të cilët ata shkruajnë, ashtu edhe me kompanitë që mbulojnë. Mos vallë të gjithë gazetarët e teknologjisë duhet thjesht të pranojnë se duke u bashkuar me korpusin e shkrimtarëve kanë bërë betim për të refuzuar tundimet e pasurive të teknologjisë?»

Le të themi po. Të paktën për të refuzuar tundimet e pasurive që vënë në pikëpyetje pavarësinë dhe besueshmërinë e raportimeve të tyre. Një gazetar i teknologjisë mund t'i shmangë konfliktet e pahijshme thjesht duke investuar vetëm në fondet e përbashkëta me bazë të gjerë. (Vetëkuptohet se këto fonde mund të zotërojnë disa aksione në teknologji. Por është edhe dikush tjetër, veç teje, që vendos se cilat aksione do të zotërojë dhe për sa kohë. Dhe sigurisht, ata që punojnë për organizata lajmesh në Internet, kanë interesa vetjake në sektor, pavarësisht nëse zotërojnë aksione apo jo – por, për hir të zotit, kjo është e zbuluar plotësisht në kartvizitën tënde.)

Tekefundit, këto nuk janë çështje të «ekonomisë së re.» Vetëshitja ka qenë tundim për gazetarët qysh kur Republika ishte në pelena. Hetimet e Kongresit mbi përmbysjen e bursës në vitin 1929 nxorën në dritë fakte se manipuluesit e tregut kishin paguar reporterë të gazetave të Nju Jorkut që t'i reklamoni aksionet sipas kërkesës. Në biografinë e shkëlqyer të Uolter Lipmanit, Ronald Stil vërente se ndërsa punonte te *New York World Telegram*, gazetari legjendar i paraluftës, Artur Krok, në fakt bënte një punë të dytë si këshilltar për marrëdhëniet publike në firmën Dillon në Rid të Uoll Stritit. Ekzistenca e një

interesi vetjak të fshehtë në cilëndo fushë që gazetari supozohet se do ta pasqyrojë në mënyrë të pavarur dhe objektive – një lëvizje politike, një dramë në Broduei, apo një aksion në Internet – dhunon konceptet e rrënjësura të etikës gazetareske. Dhe në çdo brez ka pasur gazetarë të sinqertë, por të gabuar, që besonin se rasti i tyre ishte ndryshe.

Ashtu si unë, një prej tyre ka qenë një i ardhur nga gazetaria lokale në Trenton. Në vitin 1981, ai shkoi të punonte në Shërbimin e Lajmeve të Dow Jones dhe në korrik 1982 u punësua në *Wall Street Journal* për të shkruar në rubrikën me influencë «Dëgjuar në Rrugë» të kësaj gazete.

Emri i tij ishte R. Foster Uinans.

Ashtu si gazetarët e rinj të sotëm të teknologjisë, Uinans zbuloi se jeta e tij u bë shpejt «e ndërthurur» me njerëz të pasur e të zgjuar që mbulonte. Edhe ai ishte i pakënaqur nga pagat e ulëta të gazetarisë. Edhe ai ishte i sigurt se mund të investonte mënjanë pa «lejuar kurrsesi që investimi im të ma ndryshonte gjykimin në punë.» Pak kohë pasi shkoi në *Journal* bleu fshehtas 400 aksione në American Surgery Centers, një kompani e vogël pa para të thata, duke shkruar më pas gjëra pozitive për këtë kompani në rubrikën e tij.

«E dija se ajo që po bëja ishte teknikisht joetike për një gazetar,» shkruan ai në kujtimet e tij, Tregtimi i Sekreteve: Joshje dhe Skandal në Uoll Strit Xhërnëll, botuar nga St. Martin's Press në vitin 1986. Por në njëfarë mënyre ai arsyetonte se «çështja etike kishte të bënte thjesht me dukjen.... Nëse askujt nuk do t'i binte sy, askush nuk do të perceptonte një konflikt të mundshëm dhe rrjedhimisht unë nuk kisha bërë asgjë joetike. Por ky ishte një arsyetim paksa i rumbullakosur që më pas më nxori një problem të madh.»

Shpejt Uinans ra dakord që të vinte paraprakisht në dijeni një agjent në lidhje me aksionet që do të përmendeshin në rubrikën e tij «Dëgjuar në Rrugë» në këmbim të një pjese të fitimeve. Nga kjo ujdj nxori 30.000 dollarë, më shumë nga ç'nxirrte në një vit në *Journal*. Më 29 mars 1984, drejtuesit e inatosur të gazetës botuan një shkrim ku njoftonin se kontrollorët po hetonin mbi këtë allishverish. Në qershor 1985, Uinans u dënua nën akuza të ndryshme për

mashtrime federale; më pas u dënua me 18 muaj burg. Në vitin 1987, Gjykata e Lartë e SHBA e mbështeti dënimin e tij.

Megjithëse këmbënguli deri në fund se nuk kishte shkelur ndonjë ligj, Uinans e dinte se ç'u kishte bërë kolegëve të tij gazetarë. «Unë kisha konfirmuar dyshimet e shumë investuesve për gazetarët e bursës – se ata nxjerrin përfitime vetjake nga informacionet që grumbullojnë. Kuptimi i kësaj më goditi rëndë.»

Duke e hedhur shikimin pas tani, pas 16 vjetësh, vazhdoj të ndiej se çështja Uinans i shndërroi të gjitha tundimet e frikshme të gazetarisë moderne të biznesit në një lehtësim shumë të madh për mua. Si mund t'i marrë njeriu këto gjëra për gjëra të paqarta? Mat Uelç, një kritik i mprehtë i medias i *Online Journalism Review*, më shprehu paradokohësh bindjen se nëse mëkatet e Uinansit do të kryheshin sot, ato nuk do të nxitnin as një të dhjetën e atij shpërthimi të medias që ndodhi më 1984. Ai vërejti se kur një gazetarë e rubrikës së thashethemeve në Silikon Velei pranoi aksione të lira prej një manjati lokal të teknologjisë përpara daljes së tyre në publik, shumë profesionistë gjoja të ndjeshëm ngritën zërin duke pyetur nëse ajo kish bërë ndonjë gabim. «Dhe përsëri, tani që materialet e botuara në Internet vlejnë diçka, gazetarët shikojnë sesi të gjithë këta njerëz po pasurohen – përfshirë edhe gazetarë të tjerë,» thotë Uelç. «Gjë që shumë prej tyre kjo i ka çorientuar fare.»

S'kam ç'bëj, veç të shpresoj se e ka gabim. Nëse jo, sado të pasur të bëhen gazetarët e rinj të ditëve të sotme në këtë pazar të madh lajmesh biznesi, vetë gazetaria do të jetë tej mase më e varfër.

Nën ndikimin e një vere të mirë Chardonnay le të supozojmë se shumë prej nesh do ta arrijnë majën e thepisur të skepticizmit inteligjent dhe do të ngulen mirë deri në fund duke dhënë rregullisht raportime të qarta e kokëforta mbi biznesin. Le të parashikojmë gjithashtu – po, të lutem, edhe një gotë tjetër nga ajo vera e mirë – se shumë prej nesh do ta bëjmë këtë duke i mbajtur të paprekur nderin dhe reputacionin tonë. Dhe pastaj do të flisnim prapë për atë se ç'lloj njerëzish jemi. Tekefundit, ky bum në gazetarinë e biznesit nuk ka të bëjë fare me ne. Më shumë ka të bëjë me marrëdhëniet tona me ata që përpiqemi të arrijmë – pavarësisht nëse i quajmë, lexues, shikues, apo (na ruajttë zoti!) «kundërshtarë.»

Në vitet 1980, në mënyrë instinktive e ndoshta me budallallëk, shumica e gazetarëve të rinj të biznesit i shikonin lajmet e biznesit lokal me sytë punonjësve që përfshiheshin në të – se, tekefundit, ne ishim edhe vetë punonjës – me një dyshim të përlligjur për atë që quhej menaxhim në biznesin e gazetave. Dhe me rrokullisjen e viteve 1980, «lexuesit» tanë u bënë «konsumatorë.» Kurse me fillimin e viteve 1990, këta «konsumatorë» u shndërruan në «investues.» Ndërsa sot, disa prej nesh flasin vetëm me investuesit që zotërojnë edhe modeme kompjuterash.

Gjatë gjithë kësaj rruge ka ndodhur diçka e trishtuar: me ngushtimin e auditorëve që synojmë të arrijmë, jemi ngushtuar edhe ne. Sot, lajmet e biznesit rrallë u bien akordeve kumbuese apo melodive ngazëlluese të gazetarisë së shkëlqyer. Shumica e këtyre lajmeve thjesht gumëzhin e kuis si një klarinetë e vockël në sfondin e makinave llogaritëse të banaqeve dhe të dekoreve. Burrat dhe gratë që luftuan për të shpjeguar trazirën ekonomike të viteve 1970 – rradhët në pikat e karburantit, fabrikat e mbyllura dhe gërryerjen e dukshme të konkurrencës amerikane – nuk shkruanin për konsumatorë apo investues. Ata shkruanin për qytetarë, për njerëz që vrisnin mendjen se ç'po ndodhte me këtë vend. Ata siguruan një auditor, shqetësimet e të cilit shtriheshin shumë më përtej mbarëvajtjes së planit të investimeve 401(k) dhe marrëveshjeve të qirasë për makinat e tyre Jeep Grand Cherokee.

Nuk e di për ju, por unë vetë më mirë të shkruaja përsëri për ata njerëz. Dhe kam frikë se në qoftë se nuk e bëjmë këtë, asnjë nga arritjet tona në mjeshtëri e integritet si gazetarë të biznesit nuk ka për të pasur shumë rëndësi në vitet që do të vijnë.

Diana B. Henrikes është autore e dy historive të biznesit, «Bota e Besnikërisë: Jeta e Padukshme dhe Pushteti Publik i Gjigantit të Fondit të Ndërsjelltë» dhe «Peshkaqenët e Bardhë të Uoll Stritit: Tomas Mellon Evans dhe Mësymësit Originalë të Korporatave.» Marrë nga Columbia Journalism Review. Nëntor/Dhjetor 2000.

Kodet e Etikës së Medias dhe Përtej Tyre

Nga Robert Stil dhe Xhei Blek

Kopirajti © 1999 nga Shoqëria Amerikane e Redaktorëve të Gazetave

Kodet e etikës mund ta ndihmojnë stafin e studiove të lajmeve për të marrë vendime të shëndosha dhe për të rritur besueshmërinë e gazetarisë në lidhje me problemet e shumta etike që mund të hasin në punën e tyre. Shoqëria Amerikane e Redaktorëve të Gazetave (ASNE) u kërkoi dy eticienëve të shquar të medias që të analizojnë 33 kodet sotme të etikës që u mblodhën nga Komiteti i saj për Etikën dhe Vlerat. Synimi ishte që të nxirreshin në pah aspektet më të ndeshura dhe më të dobishme të këtyre dokumenteve për t'i ndihmuar redaktorët që të vlerësonin kodin e tyre të etikës, nëse e kanë një të tillë, ose për t'i ndihmuar të krijojnë një të tillë, nëse do të donin.

Vrulli i tanishëm i shkrimit të kodeve tregon se redaktorët dhe stafet e lajmeve janë duke i marrë seriozisht çështjet e etikës. Procesi i hartimit, rihartimit, debatimit dhe zbatimit të kodeve ka një vlerë të mirë terapeutike në vetvete. Madje, gazetatat me parime e vlera të deklaruara qartë, të gërshetuara me aftësi të forta për vendimmarrje në fushën e etikës, mund t'u shërbejnë më mirë lexuesve të tyre dhe interesit publik. Pikërisht këtu qëndron edhe lidhja thelbësore me besueshmërinë.

Nuk është për t'u çuditur që të 33 kodet e etikës të ofruara nga gazetatat anëtare të ASNE përfshijnë një gamë të gjerë metodash për trajtimin e dilemave morale. Disa janë seriozë në lidhje me traditën e afirmuar nga koha, disa të tjerë marrin parasysh ndiki-

min e teknologjive të reja në kapërcyell të shekullit të ri.

Shumica e kodeve janë lista të gjata me «bë këtë dhe mos bë atë,» herë-herë me ndonjë element për procesin e vendimmarrjes. Disa përmbajnë qëndrime thjesht miqësore dhe lexohen si biseda mes kolegëve që respektojnë ambicien e secilit për shkëlqim. Të tjerët kanë tone shumë më negative, janë plot me «nuk duhet bërë» dhe me tone paternaliste duke nënkuptuar se pjesëtarët e stafeve kanë për prirje të dalin pa u lagur në çdo gjë që nuk ndalohe në mënyrë specifike prej kodeve.

Tema më e rrahur në këto kode është konflikti i interesit, i cili përfshin çështje që shtrihen nga pranimi i dhuratave dhe udhëtimet e paguara, deri te përfshirja politike dhe veprimtaritë shoqërore. Afro gjysma e kodeve që shqyrtoam trajtojnë temat e burimeve të lajmeve dhe të manipulimit të fotografive. Më pak prej tyre merren me korrigjimet dhe plagjiaturën.

Por në shumë kode mungojnë standardet apo trajtimi i privatësisë, i mashtrimit, i identifikimit të të dyshuarve minorenë dhe i etiketimeve raciale. Më pak se një në çdo pesë kode trajton temën e tensioneve midis departamenteve editoriale dhe atyre të reklamave. Shumë kode e injorojnë çështjen e zbatimit të normave.

Këto 33 kode ndryshojnë shumë edhe në gjatësi. Kodi i *The Daily Press of Newport News* në Virxhinia ka afro 8.000 fjalë, ndërsa ai i *Arizona Republic* e Feniksit, po edhe të tjerë, është relativisht konciz me 500 fjalë.

Zgjedhja e tyre nuk ka qenë rastësore, por u paraqitën vullnetarisht pas një thirrjeje të përgjithshme. Këto kode pasqyrojnë mënyrat e ndryshme në të cilat gazetatat amerikane trajtojnë çështjet e etikës.

Gjatë shikimit të këtyre 33 kode vumë re se kodet e etikës së gazetave, sikurse ato të shumicës së institucioneve profesionale, përipiqen të ofrojnë të paktën dy funksione të rëndësishme: marrëdhëniet publike dhe edukimin. Një kod i mirë gazete nxit mendimin dhe sjelljen etike brenda gazetës duke u treguar të rinjve se ku gjenden minat si dhe duke u kujtuar veteranëve vlerat dhe normat e studiove të lajmeve. Ai gjithashtu justifikon veprimtaritë e gazetarëve përpara publikut të përgjithshëm, veçanërisht gjatë kohëve kur bie besueshmëria dhe kur ka këqyrje intensive nga publiku. Këto funksione shpesh reflektohen në parathëniet e kodeve. Më poshtë vijojnë disa pjesë e shembuj nga të 33 kodet e paraqitura për t'u shqyrtuar.

Marrëdhëniet publike

Shembuj të mirë të kodeve që janë të ndjeshëm ndaj marrëdhënieve publike janë të mëposhtmit:

Kodi i *The News & Observer* në Ralei të Karolinës së Veriut, thotë:

Që *The News & Observer* të jetë burimi parësor për lajme dhe informacion për zonën, ne duhet të gëzojmë besimin dhe sigurinë e lexuesve tanë. Lexuesit duhet të dinë se gazeta që arrin në pragun e derës së tyre çdo mëngjes është për t'u shërbyer atyre dhe jo politikanëve të një ngjyre të veçantë, as grupeve të veçanta të interesave. Një gjë e tillë e vendos barrën mbi ne redaktorët përgjegjës, reporterët, redaktorët e shkrimeve, studiuesit e lajmeve, fotografët, faqosësit, artistët grafikë dhe personelin mbështetës për të shmangur konfliktet e interesave apo qoftë përshtypjen e konflikteve të tilla.

Një kod gazete që kërkon t'i kujtojë anëtarët e stafit në mënyrë elokuede për vendimmarrjen etike duke pasur parasysh imazhin publik është kodi i *Orlando Sentinel* të Floridës, i cili pohon:

Ne jemi për vlerat gazetareske të vërtetësisë, ndershmërisë, kurajës, paanshmërisë, kujdesit, pavarësisë, besueshmërisë dhe diversitetit.

Ne kërkojmë të vërtetën dhe e raportojmë atë sa më të plotë që të jetë e mundur duke pasur parasysh afatet e dorëzimit të gazetës dhe duke bërë përpjekje për një raportim të pastër, konciz e të plotë.

Ne kërkojmë dhe përhapim pikëpamje konkurruese pa u ndikuar në mënyrë të papërligjur prej atyre që e kanë në dorë të përdorin pushtetin apo pozitën e tyre.

Ne kërkojmë t'u japim një zë atyre që nuk kanë.

Ne kërkojmë t'i trajtojmë burimet, subjektet dhe kolegët si njerëz që meritojnë respektin tonë, jo thjesht si një mjet për qëllimet tona gazetareske.

Ne kërkojmë të informojmë lexuesit tanë dhe të reflektojmë ndershmërisht gjerësinë e komunitetit tonë.

Detyrimi ynë i parë është ai i besueshmërisë – domethënë përpara publikut të gjerë dhe jo përpara ndonjë personi, biznesi apo interesi të veçantë. Punonjësit duhet të shmangin çdo lloj veprimtarie që do të dobësonte integritetin e tyre apo do të rrezikonte besimin e lexuesve tek ne.

Konflikti i Interesave

Siç u vu në dukje më lart, konflikti i interesave, përfshirë çështjet e pavarësisë dhe të sjelljes vetjake, është elementi më i trajtuar në kodet që kemi shqyrtuar.

Vetëm një prej 33 gazetave nuk e trajton këtë çështje, kurse një e katërta e kodeve merren vetëm me çështje të konfliktit të interesave duke mos i kushtuar aspak vëmendje ndonjë çështjeje tjetër. Në deklaratën e saj me 2.000 fjalë mbi «Mbledhjen Etike të Lajmeve,» gazeta *San Francisco Chronicle* (në Kaliforni) merret me çështje të mbledhjes së lajmeve, por nuk e trajton konfliktin e interesave.

Elementi i dytë më i shpeshtë i kodeve që kemi shqyrtuar është burimi i lajmeve. Nga të 33 kodet,

18 merren me çështje të marrëdhënieve burim-reporter dhe, në njëfarë mënyre, me marrëveshjet e konfidencialitetit. Disa gazeta e trajtojnë këtë çështje me pak fjali, ndërsa disa të tjera u kushtojnë shumë faqe të politikave të tyre.

Është interesante se çështja e manipulimit dhe e modifikimit të fotove përfshihet në afro gjysmën e 33 kodeve. Dhjetë vjet më parë një çështje të tillë nuk e gjeje fare në shumicën e kodeve.

Është pak çuditshme, por gati gjysma e 33 kodeve që shqyrtoam trajton çështjen e korigjimeve. Vetëm 13 prej 33 kodeve përfshijnë diçka mbi plagjiaturën.

Çështjet e mashtrimit dhe të pasqyrimin të shtrembër përfshihen edhe më pak. Vetëm 11 nga 33 kodet i kushtojnë kësaj çështjeje njëfarë vëmendjeje. Ndërsa disa prej kodeve merren gjerësisht me çështjet e privatësisë duke dhënë edhe udhëzime për mbledhjen e lajmeve, vetëm një e katërta e kodeve e trajtojnë deri diku këtë çështje. Afërsisht e njëjta përqindje e kodeve merret me tema të trajtimit të citimeve dhe me çështje të sajimit të personazheve apo të bisedave. Vetëm katër kode përfshijnë ndonjë udhëzim mbi njërën prej çështjeve të vështira me të cilat përballen sot gazetatat: identifikimi i të dyshuarve dhe në veçanti identifikimi i të dyshuarve të mitur.

Vlerat e Përhershme

Nuk ka dyshim se këto kode u kushtojnë një vëmendje të madhe parimeve themelore të gazetarisë dhe vlerave të përhershme. Më poshtë vijojnë disa prej shembujve më të mirë.

Në seksionin mbi ndershmërinë, *Journal News* i Uajt Pleins në Nju Jork (dikur me emrin *Gannett Suburban Newspapers*) përfshin sa më poshtë:

Insinuatat kundër një individi shpesh kërkojnë një përgjigje. Nëse personi nuk mund të kontaktohet, thuajeni këtë, por vetëm pasi të keni bërë një përpjekje serioze për të arritur tek ai. Nëse është e mundur, shqyrtoni mundësinë e shtyrjes së botimit për të kontaktuar palën tjetër; nëse kjo nuk është e mundur, kini parasysh që të vazhdoni përpjekjet për ta kontaktuar personin për një suplement në botime të mëvonshme ose në një artikull pasues. Nëse botimi i një lajmi është vo-

nuar, duhet shqyrtuar mundësia për përpjekje të tjera për të kontaktuar personat, të cilët në kohën e shkrimit nuk mund të kontaktoheshin.

Teknologjia e Re

Journal Gazette (Fort Uein, Indiana) është një prej gazetave të pakta që arrin të trajtojë çështje të Internetit në politikën e vet për etikën:

Zbatoni standardet tona të larta për saktësi dhe atribuim autorësie në çdo gjë që gjeni gjatë përdorimit të shërbimeve elektronike. Sigurohuni që komunikimi të jetë i vërtetë dhe informacioni i saktë përpara se ta përdorni në një lajm.

Çështjet e etikës në përdorimin e Internetit i trajton edhe gazeta *The News & Observer* e Raleit. Seksioni i saj mbi plagjiaturën përmban:

Mos paraqisni idetë apo shkrimet e njerëzve të tjerë duke pretenduar se janë tuajat. Me shpërthimin e Internetit, të gjithë kemi më shumë mundësi për më shumë informacion nga më shumë burime, por duhet t'i rezistojmë tundimit për ta përdorur atë pa atribuim autorësie. Kjo politikë është e thjeshtë dhe e sigurt: mos e bëni.

Burimet dhe Reporterët

Kodi i gazetës *San Francisco Chronicle* ofron një prej trajtimeve më të qarta mbi çështjet gjithnjë të mprehta të burimeve që kërkojnë konfidencialitet. Një pjesë thotë:

Një gazetar që i premtom konfidencialitet një burimi nuk duhet ta shkelë atë premtim. Nëse redaktori i kërkon reporterit identitetin e një burimi, reporteri duhet ta vërë në dijeni burimin për këtë kërkesë të redaktorit. Nëse burimi dëshiron që ta mbajë identitetin e tij ose të saj të panjohur për redaktorin, atëherë reporteri dhe redaktori duhet të vendosin nëse do ta përdorin apo jo informacionin edhe pse identiteti i burimit mbetet i njohur vetëm për reporterin.

Pavarësia Redaksionale

Gazeta *Kansas City Star* (në Misuri) është një prej gazetave të pakta në studimin tonë që merret me ten-

sionet e mundshme mes roleve që kanë aspektet redaksionale dhe ato të biznesit të gazetës. Në seksionin për konfliktin e interesave të kodit të etikës, për politikën e gazetës thuhet:

Mbani një kufi të qartë midis reklamave dhe lajmeve. Ne jemi gjithnjë tërheqës, si tabelë qitjeje, për t'u kërcënuar se do të na i heqin reklamat nëse nuk shkruajmë artikuj pozitivë. Në rastet e rubrikave speciale të hapura nga departamenti i redaksisë, redaktorët do të ushtrojnë gjykim vetëm mbi përmbajtjen.

Në lidhje me pavarësinë gazetareske në një epokë qëndrimesh të reja ndaj raportimit dhe lidhjeve komunitare, politika e etikës së studios së lajmeve e gazetës *Statesmen Journal* në Salem të Oregonit thotë:

Tregohuni të kujdesshëm kur bashkëpunoni me qeverinë apo me institucione të tjera për projekte publike të gazetarisë. Shpesh këto përpjekje ia vlejné dhe janë në interesin e lexuesve. Por ato edhe mund ta kompromentojnë pavarësinë tonë.

Çështjet e Diversitetit dhe të Identifikimit Racial

Një prej çështjeve më sfiduese që ndeshin gazetat është trajtimi i çështjeve të diversitetit, përfshirë përdorimin e racës si identifikuese nëpër artikuj e subjekte me etiketime raciale. Vetëm pesë prej 33 gazetave e trajtojnë këtë çështje në kodet e tyre.

Gazeta *Journal News* e Uajt Pleins shfaq një qëndrim më të detajuar në materialin e vet «Standarde të Sjelljes Profesionale» për punonjësit e lajmeve:

Nëse nuk është e rëndësishme për artikullin, mos e përshkruani një person për nga raca, feja apo përkatësia etnike. Mos citoni barceleta apo fyerje raciale, etnike apo fetare nëse nuk janë të domosdoshme për artikullin (dhe rrallë janë të tilla).

Në përshkrimet e të dyshuarve për krime mos përdorni karakterizime raciale apo etnike, përveç rasteve kur janë pjesë e një përshkrimi mjaft të plotë për një të dyshuar të arratisur, gjë që në mënyrë të arsyeshme do të vliente që publiku të ndihmonte policinë.

Të jeni veçanërisht të ndjeshëm ndaj nuancave të përdorimit të çfarëdolloj reference që mund të jetë fyese për një grup të pakicës. Nëse ka alternativa jofyese, i përdorni.

Artikujt, ilustrimet dhe fotografitë duhet të jenë normale, gjë që do të thotë se duhen bërë përpjekje për të përfshirë përfaqësimin e pakicave në mënyrë të zakonshme me qëllim që lajmet tona të pasqyrojnë më me saktësi përbërjen e komuniteteve që mbulojmë.

Të jeni të matur në karakterizimet raciale në fotografi.

Zbatimi

Nga të 33 kodet që shqyrtoam, shumë prej tyre nuk e trajtojnë zbatimin e normave. Por edhe tek ato që e trajtojnë, trajtimi zakonisht është i shkurtër e i përgjithshëm. Shumë prej kodeve përmbajnë njëfarë reference ndaj faktit që asnjë kod nuk mund t'i parashikojë të gjitha problemet, duke sugjeruar nevojën për konsultim me eprorët kurdo që del një problem i mundshëm. Megjithatë, disa e shpjegojnë qartë procesin sistematik për të bërë publike një ankesë apo për të zgjidhur një konflikt.

Kodi etik i gazetës *Dallas Morning News* (Teksas) thjesht pohon se «shkelja e disa udhëzimeve mund të rezultojë në masa disiplinore apo pushim.»

Gazeta *News Journal* në Uilmington të Delauerit jep trajtimin më të qartë lidhur me zbatimin e kodit të saj. Ajo përfshin shtatë pika specifike, një prej të cilave flet për konceptin e respektimit të kodit të ndërit: «Është detyrim i pjesëtarëve të stafit që të vënë në dijeni eprorin apo redaktorin për çdolloj shkeljeje të këtij kodi.»

Kodet dhe Besueshmëria

Ndërkohë që të 33 kodet që shqyrtoam trajtojnë standarde specifike për sjelljen individuale përgjithësisht me terma negativë «nuk duhet të,» vetëm rreth gjysma përdorin terma pozitivë për të shprehur qartë rolet, detyrimet morale dhe përgjegjësitë profesionale të gazetarëve.

Toni i dritës së kuqe që thekson kufizimet karshi tonit të dritës jeshile që thekson detyrat dhe përgjegjësitë, mund ta mbrojë gazetën në disa aspekte, por mund ta bëjë më të pambrojtur në disa të tjera. Duke lexuar kodet mund të konkludojmë vetëm për atë se sa studio lajmesh kanë një proces të përpunuar mirë për vendimmarrjen. Por nëse i kemi lexuar saktë, duket se në shumicën e këtyre studiove të lajmeve dhe të paktën në lidhje me çështjet e trajtuara në këto kode, zgjidhja e dilemave etike qëndron më shumë në respektimin e një libri rregullash dhe të zërit zyrtar të eprorëve dhe më pak në të menduarit kritik, në diskutimet me kolegët dhe në protokollet e efektshme të vendimmarrjes.

Eticienët kanë qejf të thonë se mbështetja te kodet është pika e mesme midis përkushtimit të thellë ndaj instinkteve të brendshme dhe zbatimit të reflektimit dhe të arsytimit etik. Dhe vërtet, bindja e verbër përpara rregullave të kodifikuara është e barabartë me bindjen e verbër përpara autoritetit apo traditës së padiskutueshme. Në rastin më të mirë, kodet na largojnë nga sjelljet dogmatike duke na afruar drejt sjelljeve të arsyetuara mbi bazën e mençurisë së epokave. Kodet nuk janë zgjidhje për të gjitha dilemat

etike as në lajme, as në ndonjë biznes tjetër dhe nuk janë as zgjidhje për krizat e kredibilitetit.

Po citoj atë që shkruam në *Quill*, revista zyrtare e Shoqërisë së Gazetarëve Profesionistë (SPJ), pas rishikimit që SPJ i bëri kodit të vet më 1996: «Kodet e shkruara me kujdes theksojnë dhe parashikojnë dilema etike në mënyrë që të mos na duhet të rishpikim procese vendimmarrjesh sa herë që mund të gjendemi përpara një dileme të re; na frymëzojnë për rolet dhe përgjegjësitë tona unike; e bëjnë secilin prej nesh rojtar të vlerave e të sjelljeve të profesionit tonë dhe na frymëzojnë të ndjekim më të mirën e profesionit tonë; na nxitin që në krye një vendimmarrje largpamëse përpara se vendimet tona të dalin në publik.»

Robert Stil është drejtor i programit të etikës në Institutin Pointer në San Pitërsbërg të Floridës. Xhej Blek është kryetar i Pointer-Xhemison në etikën e medias në Universitetin e Floridës së Jugut në San Pitërsbërg.

BIBLIOGRAFI

Libra e dokumente

Allan, Stuart

NEWS CULTURE

Open University Press, 1999, 229 f.

American Society of Newspaper Editors

(Shoqëria Amerikane e Redaktorëve të Gazetave)

DEKLARATA E PARIMEVE E ASNE

The Society, 1975

Gjendet te <http://www.asne.org/kiosk/archive/principl.htm>

Cook, Timothy E.

GOVERNING WITH THE NEWS: THE NEWS MEDIA AS A POLITICAL INSTITUTION

University of Chicago Press, 1998, 264 f.

Corrigan, Don H.

THE PUBLIC JOURNALISM MOVEMENT IN AMERICA: EVANGELISTS IN THE NEWSROOM

Greenwood Publishing, 1999, 256 f.

Creech, Kenneth C.

ELECTRONIC MEDIA LAW AND REGULATION

Butterworth-Heinemann, botimi i 3-të, 1999, 336 f.

de Burgh, Hugo, redaktor

INVESTIGATIVE JOURNALISM: CONTEXT AND PRACTICE

Routledge, 2000, 336 f.

Greenwald, Marilyn, and Joseph Bernt, redaktorë

THE BIG CHILL: INVESTIGATIVE REPORTING IN THE CURRENT MEDIA ENVIRONMENT

Iowa State University Press, 1999, 280 f.

Hachten, William A.

THE TROUBLES OF JOURNALISM: A CRITICAL LOOK AT WHAT'S RIGHT AND WRONG WITH THE PRESS

Lawrence Erlbaum Associates, botimi i 2-të, 2001, 208 f.

Moore, Roy L

MASS COMMUNICATION LAW AND ETHICS

Lawrence Erlbaum Associates, botimi i 2-të, 1999, 696 f.

Pritchard, David Hemmings, redaktor

HOLDING THE MEDIA ACCOUNTABLE: CITIZENS, ETHICS AND THE LAW

Indiana University Press, 2000, 240 f.

Radio-Television News Directors Association

(Shoqata e Drejtorëve të Lajmeve të Radio-Televizioneve)

CODE OF ETHICS AND PROFESSIONAL CONDUCT

The Association, 2000

Gjendet te <http://www.rtna.org/ethics/coe.shtml>

The Reporters Committee for Freedom of the Press

(Komiteti i Reporterëve për Lirinë e Shtypit)

THE FIRST AMENDMENT HANDBOOK

The Committee, 1999

Gjendet te <http://www.rcfp.org/handbook/viewpage.cgi>

Smith, Ron F.

GROPING FOR ETHICS IN JOURNALISM

Iowa State University Press, botimi i 4-t, 1999, 382 f.

Society of Professional Journalists

(Shoqëria e Gazetarëve Profesionistë)

SPJ CODE OF ETHICS

The Society, 1996

Gjendet te <http://spj.org/ethics/code.htm>

Sparks, Colin, and John Tulloch, redaktorë

TABLOID TALES: GLOBAL DEBATES OVER MEDIA STANDARDS

Rowman and Littlefield, 2000, 315 f.

ARTIKUJ

Bugeja, Michael

ETHICS ARE LIVED, NOT LEARNED

Quill, Vëll. 88, Nr. 3, Prill 2000, f. 15–17

Garcia, Jason

ETHICS HOTLINE

American Journalism Review, Vëll. 23, Nr. 2, Mars 2001, f. 17

Jennings, Marianne

IN SEARCH OF JOURNALISTIC ETHICS

USA Today, Vëll. 129, Nr. 2662, Korrik 2000, f. 56–57

Kelly, Missy

ETHICAL CHALLENGES IN ONLINE NEWS

World & I, Vëll. 15, Nr. 10, Tetor 2000, f. 64–69

LaMont, Sanders

LISTENING TO READERS: LENDING AN EAR

The American Editor, Nr. 803, Shtator 1999, f. 4+

Moses, Lucia

*IS THERE A DOCTOR IN THE HOUSE? INCREASINGLY,
NEWSPAPERS CALL ON OMBUDSMEN TO CURE WHAT AILS
THEM*

Editor & Publisher, Vëll. 133, Nr. 2, 10 Janar, 2000, f. 22–26

Robertson, Lori

ETHICALLY CHALLENGED

American Journalism Review, Vëll. 23, Nr. 2, Mars 2001, f. 20–29

Steele, Bob, and Black, Jay

*CAN YOU IMPROVE YOUR CODE OF ETHICS?
(OR CREATE A GOOD CODE IF YOU DON'T HAVE ONE?)*

The American Editor, Nr. 798, Shkurt 1999, f. 4–9

Trigoboff, Dan

NEWS RULES

Broadcasting & Cable, Vëll. 130, Nr. 38, 11 Shtator, 2000, f. 52, 54

Voakes, Paul

*CIVIC DUTIES: NEWSPAPER JOURNALISTS'
VIEWS ON PUBLIC JOURNALISM*

Journalism and Mass Communication Quarterly, Vëll. 76, Nr. 4,
Dimër 1999, f. 756–774

Zacchino, Narda

READERS NOTICE ETHICAL LAPSES

Quill, Vëll. 88, Nr. 4, Maj 2000, f. 28–29

Burime të Përzgjedhura në Internet

American Society of Newspaper Editors (ASNE)

(Shoqëria Amerikane e Redaktorëve të Gazetave)

ASNE është organizata kryesore e redaktorëve të gazetave të përditshme të Amerikave.

<http://www.asne.org>

The Committee to Protect Journalists (CPJ)

(Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve)

CPJ është një organizatë jofitimprurëse, jopartiake e përkushtuar ndaj mbrojtjes globale të lirisë së shtypit

<http://www.cpj.org>

Facsnet

Facsnet i është përkushtuar përmirësimit të cilësisë së informacionit që arrin te publiku përmes lajmeve si dhe ofrimit të programeve arsimore, botimeve dhe burimeve në Internet.

<http://www.facsnet.org>

The Freedom Forum

(Forumi i Lirisë)

The Freedom Forum është një fondacion ndërkombëtar, jopartiak, i përkushtuar ndaj lirisë së shtypit e të fjalës.

<http://www.freedomforum.org>

The International Press Institute

(Instituti Ndërkombëtar i Shtypit)

International Press Institute është një rrjet botëror gazetarësh, redaktorësh dhe drejtorësh ekzekutivë të mediave, i përkushtuar ndaj lirisë së shtypit dhe përmirësimit të standardeve dhe praktikave të gazetarisë.

<http://www.freemedia.at/index1.html>

Investigative Reporters and Editors, Inc. (IRE)

(Reporterët dhe Redaktorët Hulumtues)

IRE punon për të ruajtur standarde të larta profesionale dhe ofron shërbime edukative për reporterët, redaktorët dhe njerëz të tjerë të interesuar për gazetarinë investiguese.

<http://www.ire.org>

Newspaper Association of America

(Shoqata e Gazetave e Amerikës)

Një derë në Internet për të hyrë në një mori sajtesh me gazeta, të përjavshme lajmesh, botime biznesi dhe burime alternative lajmesh në Amerikën e Veriut e në botë.

<http://www.naa.org/hotlinks>

The Organization of News Ombudsmen (ONO)

(Organizata e Avokatit Qytetar të Lajmeve)

ONO është një korporatë jofitimprurëse ndërkombëtare e përkushtuar ndaj mbajtjes së kontakteve me avokatë qytetarë të lajmeve në mbarë botën.

<http://www.infi.net/ono>

Pew Center for Civic Journalism

(Qendra Pju për Gazetarinë Qytetare)

Një qendër përpjekjesh novatore në fushën e gazetarisë që përpiqet të gjejë e të përmirësojë rrugë më të mira për raportimin e lajmeve me qëllim që qytetarët të angazhohen në jetën e komuniteteve.

<http://www.pewcenter.org>

The Pew Research Center for the People and the Press

(Qendra Pju e Kërkimeve për Njerëzit dhe Shtypin)

Një grup i pavarur kërkimor opinionesh i sponsorizuar nga Pew Charitable Trusts që studion qëndrimet e publikut ndaj shtypit, politikës dhe çështjeve të politikave publike.

<http://www.people-press.org>

The Poynter Institute

(Instituti Pointer)

Instituti Pointer është një shkollë për gazetarët, e cila i është përkushtuar nxitjes së përsosjes dhe integritetit në projektimin dhe drejtimin e ndërmarrjeve të suksesshme gazetareske.

<http://www.poynter.org>

Radio-Television News Directors Association (RTNDA)

(Shoqata e Drejtorëve të Lajmeve të Radio-Televizioneve)

RTNDA është një shoqatë për gazetarët radiotelevizivë. Në bashkëpunim me Fondacionin e Drejtorëve të Lajmeve të Radio-Televizioneve, RTNDA nxit përsosjen në gazetarinë radiotelevizive përmes kërkimeve, arsimit dhe kualifikimit të profesionistëve të lajmeve dhe të studentëve të gazetarisë.

<http://www.rtna.org>

The Reporters Committee for Freedom of the Press

(Komiteti i Reporterëve për Lirinë e Shtypit)

Një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar ndaj ofrimit të ndihmës ligjore falas gazetarëve dhe mediave.

<http://www.rcfp.org>

The Society of Professional Journalists

(Shoqëria e Gazetarëve Profesionistë)

Shoqëria e Gazetarëve Profesionistë është organizata më e madhe dhe më e gjerë e gazetarisë në SHBA, e përkushtuar ndaj inkurajimit të ushtrimit të lirë të gazetarisë dhe nxitjes së standardeve të larta të sjelljes etike.

<http://www.spj.org>